

“Analiza e nivelit te decentralizimit fiskal në Republikën e Shqipërisë, rast studimor bashkia e Dibrës”



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIMET PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

PUNIM MAGJISTRATURE

**“Analiza e nivelit te decentralizimit fiskal në Republikën e Shqipërisë ,
rast studimor bashkia e Dibrës”**

MENTOR:

Prof.Dr.Rufi OSMANI

KANDIDATI:

Pranvera LAMI

Tetovë, 2022

Permbajtja

Abstrakt	4
Abstract	5
Апстрактно	6
Lista e tabelave	9
Lista e grafikeve	11
1. Hyrje	
1.1Lënda e hulumtimit.....	13
1.2Qëllimet e hulumtimit.....	15
1.3Hipotezat.....	16
1.4Metodologjia e hulumtimit.....	16
1.5Rëndësia e punimit.....	17
2. Rishikimi I literatures	
2.1 Çfarë është decentralizimi fiskal.....	18
2.2Procesi I Decentralizimit fiskal në Shqipëri.....	21
2.3Decentralizimi fiskal dhe matja e treguesëve të tij	26
2.4 Ndikimi I decentralizimit fiskal në zhvillimin ekonomik vendor.....	30
2.5Pushteti qëndror në Shqipëri.....	33
2.6 Pushteti vendor në Shqipëri	34
2.7Mardhëniet e pushtetit qëndror me atë vendor.....	36
2.8Funksionet e pushtetit vendor.....	38

2.9 Buxheti dhe rëndësia e tij.....	40
2.10 Struktura e buxhetit vendor.....	41

3. Analiza e buxheteve të Bashkisë Dibër

3.1 Analiza financiare e buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2016.....	43
3.2 Analiza financiare e buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2017.....	46
3.3 Analiza financiare e buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2018.....	49
3.4 Analiza financiare e buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2019.....	52
3.5 Analiza financiare e buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2020.....	55
3.6 Krahasimi i buxheteve të Bashkisë për periudhën kohore 2016-2020.....	59
3.7 Gjendja e llogarisë së Bashkisë Dibër në fundvit për vitet 2016-2020.....	64
3.8 Detyrimet e prapambetura për Bashkinë Dibër për vitet 2016-2020.....	65
3.9 Transfeta specifike dhe transfera e pakushtëzuar për vitet 2016-2020.....	67

4. Përfundime dhe rekomandime

4.1 Përfundimet

4.2 Rekomandime

Literatura:

Abstrakt

Në këtë studim do të realizohet analiza e nivelit të decentralizimit fiskal në Shqipëri duke marrë si rast studimor Bashkinë Dibër. Procesi I decentralizimit në Shqipëri I pati fillesat e tij që me nisjen e periudhës së transicionit me ndryshimin e sistemit në vitin 1992. Një ndër detyrat kryesore që kishte qeveria në vitet e para pas ndryshimit të sistemit ishte ndërtimi I të gjithë strukturave të qeverisjes vendore, por ky pushtet mori trajtë të plotë pasi u miratua “Strategjia Kombëtare e Decentralizimit” dhe u miratua ligji “ Për Organizim dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” në nëntor të vitit 2000.

Bashkia Dibër është bashkia e tretë në Shqipëri për nga sipërfaqja me një sipërfaqe prej 937.88 km² , ndërsa për sa I përket popullsisë ka 78,940 banorë. Qendra e kësaj Bashkie është qyteti i Peshkopisë dhe ka 15 njësi administrative. Njësitë administrative të Bashkisë Dibër janë: Peshkopi, Maqellarë, Kastriot, Melan, Muhurr, Arras, Sllovë, Luzni, Fushë Cidhen, Kala e Dodës, Lurrë, Selishtë, Zall-Dardhë dhe Zall-Rec. Të gjitha njësitë janë nën varësinë e Bashkisë Dibër.

Në këtë punim është bërë analiza financiare e buxhetit të bashkisë për vitet 2016-2020. Analiza financiare e buxhetit të Bashkisë Dibër është realizuar duke krahasuar evidencat e të ardhurave dhe evidencat e shpenzimeve për të parë trendit që kanë pasur gjatë viteve 2016-2020 dhe duke përlogaritur në këtë mënyrë përqindjet e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Sipas analizës analitike dhe strukturore të buxhetit për vitet 2016-2020 vërejmë se buxheti I Bashkisë Dibër ka pasur një trend rritës pavarësisht sfidave që ka përjetuar vendi ynë dhe jo vetëm gjatë viteve të fundit, duke përmendur këtu tërmetin e vitit 2019 dhe pandeminë

Covit-19, që u bë një problem mbarë botëror. Ndonëse nuk ka pasur një rritje të konsiderueshme vlen të përmendet se ka pasur një trend pozitiv rritës.

Këto analiza janë realizuar në bazë të të dhënave të marra nga raportet financiare në sektorin e financës pranë Bashkisë Dibrë.

Fjalët kyçe: Bashkia Dibrë, buxheti, evidenca e të ardhurave, evidenca e shpenzimeve, përqindja e realizimit, detyrimet e prapambetura.

Abstract

In this study, the analysis of the level of fiscal decentralization in Albania will be realized, taking as a case study the Municipality of Dibrë. The process of decentralization in Albania had its beginnings with the beginning of the transition period with the change of the system in 1992. One of the main tasks of the government in the first years after the change of the system was the construction of all local government structures, but this power took full shape after the adoption of the "National Strategy for Decentralization" and the adoption of the law "On the Organization and Functioning of Local Government" in November 2000.

Dibrë Municipality is the third municipality in Albania in terms of area with an area of 937.88 km², while in terms of population it has 78,940 inhabitants. The center of this Municipality is the city of Peshkopi and 15 administrative units. The administrative units of the Municipality of Dibrë are: Peshkopi, Maqellarë, Kastriot, Melan, Muhurr, Arras, Slllovë, Luzni, Fushë Cidhen, Kala e Dodës, Lurrë, Selishtë, Zall-Dardhe and Zall-Rec. All units are under the jurisdiction of the Municipality of Debar.

In this paper is made the financial analysis of the budget of the municipality for the years 2016-2020. The financial analysis of the budget of the Municipality of Dibrë is done by making records of revenues and records of expenditures to see the trend they had during the years 2016-2020 and calculated in this way the percentages of realization of income and expenses. According to the analytical and structural analysis of the budget for the years 2016-2020, we notice that the budget of the Municipality of Dibrë has had an increasing trend despite the challenges that our country has experienced and not only in recent years, mentioning here the 2019 earthquake and the Covit-19 pandemic, which became a worldwide problem. Although there has been no significant increase it is worth noting that there has been a positive upward trend.

These analyzes were performed based on data obtained from financial reports in the financial sector near the municipality of Dibrë.

Keywords: Dibrë Municipality, budget, revenue records, expenditure records, percentage of realization, arrears.

ABSTRAKT

Vo ova studija ke se realizira analiza na nivoto na fiskalna decentralizacija vo Albanija, zemajki ja kako studija na slučaj opština Dibra. Procesot na decentralizacija vo Albanija gi imaše svoite početoci so početokot na tranziciskiot period so promenata na sistemot vo 1992 godina.

Edna od glavnite zadači na vladata vo prvite godini po promenata na sistemot beše izgradbata na celata lokalna vlast. strukturi, no ova vlast dobi celosna forma po usvojuvanjeto na „Nacionalnata strategija za decentralizacija“ i usvojuvanjeto na zakonot „Za organizacija i funkcioniranje na lokalnata samouprava“ vo noemvri 2000 godina.

Opština Dibra e treta opština vo Albanija po površina so površina od 937,88 km², dodeka po naselenie ima 78.940 žiteli. Centar na ova opština e gradot Peškopeja i 15 administrativni edinici. Administrativnite edinici na opština Dibr se: Peškopeja, Mačelara, Kastriot, Melan, Muhur, Aras, Slovo, Lužni, Fuša Ciden, Kala e Doda, Lurre, Selište, Zal-Darhe i Zal-Rec. Site edinici se vo nadležnost na opština Dibra.

Vo ovoj trud e napravena finansiskata analiza na budžetot na opštinata za godinite 2016-2020. Finansiskata analiza na budžetot na opština Dibra e napravena so pravenje evidencija na prihodite i evidencija na rashodite za da se vidi trendot što go imale vo tekot na godinite 2016-2020 godina i na ovoj način se presmetani procentite na realizacija na prihodite i rashodite.

Spored analitičkata i strukturnata analiza na budžetot za godinite 2016-2020, zabeležuvame deka budžetot na opština Dibra beleži trend na porast i pokraj predizvicite što gi doživea našata država i ne samo vo poslednite godini, pri što ovde se spomenuva Zemjotresot od 2019 godina i pandemijata Kovit-19. , koja stana svetski problem. Iako nema značitelno zgolemuвање, vredi da se napomene deka ima pozitiven nagoren trend.

Ovie analizi se napraveni vrz osnova na podatocite dobieni od finansiskite izveštai vo finansiskiot sektor vo na opština Dibra.

Ključni zborovi: opština Dibra, budžet, evidencija na prihodi, evidencija na rashodi, procent na realizacija, zaostanati dolgovi.

Falenderim

Është e vështirë ti shprehësh falenderimet me pak fjalë për ato njerëz që më ndihmuan kaq shumë. Falenderimi kryesor shkon për familjen time, të cilët më inkurajuan dhe më motivuan që të arrij të jem këtu ku jam sot. Punimi I masterit kërkon një përkushtim të vecantë dhe arrita të realizoj në sajë të mbështetjes së familjes sime.

Një falenderim tejet I vecantë shkon edhe për mentorin prof. Rufi Osmanin, I cili më ka ndjekur dhe këshilluar në cdo hap të realizimit të këtij punimi.

Në fund një falenderim I përzemërt shkon për fëmijët e mi të mrekullueshëm Leonardon, Lusian dhe Lunën që janë motivimi im në cdo hap që bëj.

FALEMINDERIT!

Deklarata e autorësisë

Unë e nënshkruara Pranvera LAMI deklaroj se punimi I masterit me titull “Analiza e nivelit të decentralizimit fiskal në Shqipëri, rast studimor Bashkis e Dibrës” është realizuar nga unë dhe asnjëherë më parë nuk është prezantuar në ndonjë universitet tjetër. Deklaroj se cdo material që është marrë nga burimet e treta është referuar sipas rregullave.

Lista e tabelave

Tabela nr.1: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2016

Tabela nr.2: Realizimet e të ardhurave për vitin 2016

Tabela nr.3: Realizimet e të shpenzimeve për vitin 2016

Tabela nr.4: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2017

Tabela nr.5: Realizimet e të ardhurave për vitin 2017

Tabela nr.6: Realizimet e të shpenzimeve për vitin 2017

Tabela nr.7: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2018

Tabela nr.8: Realizimet e të ardhurave për vitin 2018

Tabela nr.9: Realizimet e të shpenzimeve për vitin 2018

Tabela nr.10: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019

Tabela nr.11: Realizimet e të ardhurave për vitin 2019

Tabela nr.12: Realizimet e të shpenzimeve për vitin 2019

Tabela nr.13: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2020

Tabela nr.14: Realizimet e të ardhurave për vitin 2020

Tabela nr.15: Realizimet e të shpenzimeve për vitin 2020

Tabela nr.16: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave nga fondet për vitet 2016-2020

Tabela nr.17. Gjendja e llogarisë në fundvit për vitet 2016-2020

Tabela nr.18: Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Dibër për vitet 2016-2020

Lista e grafikeve

Grafiku 1 :Të ardhurat e qeverisë lokale si pjesë e PBB-së dhe të ardhurave totale publike (2008-2018)

Grafiku 2: Të ardhurat e qeverisë lokale dhe të ardhurat totale publike në Shqipëri

Grafiku 3: Përbërja e të ardhurave le totali në përqindje në Shqipëri

Grafiku 4: Përbërja e shpenzimeve lokale, totali në përqindje në Shqipëri

Grafiku 5: Investime nga niveli i qeverisë si % e PBB-së në Shqipëri

Grafiku 6: Të ardhurat e realizuara për vitin 2016

Grafiku 7: Shpenzimet e realizuara për vitin 2016

Grafiku 8: Të ardhurat e realizuara për vitin 2017

Grafiku 9: Shpenzimet e realizuara për vitin 2017

Grafiku 10: Të ardhurat e realizuara për vitin 2018

Grafiku 11: Shpenzimet e realizuara për vitin 2018

Grafiku 12: Të ardhurat e realizuara për vitin 2019

Grafiku 13: Shpenzimet e realizuara për vitin 2019

Grafiku 14: Të ardhurat e realizuara për vitin 2020

Grafiku 15: Shpenzimet e realizuara për vitin 2020

Grafiku 16: Projektionet dhe realizimet e grantit për vitet 2016-2020.

Grafiku 17: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave vetanake për vitet 2016-2020.

Grafiku 18: Projektionet dhe realizimet e fondeve për vitet 2016-2020.

Grafiku 19: Gjendja e llogarise së Bashkisë Dibër për vitet 2016-2020

Grafiku 20: Detyrimet e prapambetura për vitet 2016-2020

Grafiku 21: Transfeta specifike dhe transfera e pakushtëzuar për vitet 2016-2020

1. Hyrje

1. Lënda e hulumtimit

Procesi i ndërtimit të një sistemi politik demokratik dhe funksionimi i një ekonomie tregu në vendet e Ballkanit Perëndimor përfshin gjithashtu reformat politike dhe decentralizimin fiskal, duke marrë parasysh gjithashtu diversitetin e veçantë politik, ekonomik dhe etnik të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në rastin e Shqipërisë dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor decentralizimi politik dhe fiskal ka realizuar pjesërisht qëllimet për të ndërtuar një demokraci lokale funksionale dhe një nivel të qëndrueshëm financiar dhe fiskal të bashkive dhe komunave edhe si pasojë e faktit se Shqipëria ka nivelin më të lartë të centralizimit të financave publike në nivel të Ballkanit Perëndimor dhe me gjerë .

Organizimi territorial, numri i komunave dhe numri i popullsisë sipas komunave në vende të ndryshme të BE -së dhe Ballkanit Perëndimor reflekton specifikat territoriale, ekonomike, etnike, kulturore dhe politike të vendeve të analizuar. Këto informacione janë produkt i një procesi shumë kompleks të vendimmarrjes politike me synimin për të kapërcyer dallimet ndër etnike,

ndër rajonale dhe mosmarrëveshjet politike dhe zgjidhjen e zhvillimit asimetrik të trashëguar në nivel lokal dhe rajonal.

Karakteristikat e përbashkëta të të gjitha shteteve të BP është përqendrimi i popullsisë më të madhe në kryeqytete, fakt i cili shoqërohet me përqendrim të lartë të potencialit ekonomik dhe fiskal që ndikon në favorizimin e kryeqyteteve dhe dëmtimin e rajoneve të tjera të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor (Osmani 2017)

Subsidiariteti dhe bashkëpunimi janë parimet kryesore ku bazohet marrëdhënia e pushtetit vendor me pushtetin qendror për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta. Ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor ka një marrëdhënie ndërvarësie. Vendimet strategjike merren nga organet e pushtetit qendror dhe me pas këto vendime zbatohen nga organet e pushtetit vendor.

Procesi i decentralizimit i cili nisi që pas viteve '90 nënkupton transferimin e autoritetit dhe përgjegjësisë së funksioneve publike nga pushteti qendror në atë vendor ose në institucione të tjera të nivelit lokal, gjithashtu procesi i decentralizimit u jep të drejtë qytetarëve për të marrë pjesë në administrimin e punëve publike nëpërmjet përfaqësuesve në Këshillin Bashkiak. Decentralizimi e sjell procesin e vendim marrjes për shërbimet dhe të mirat komunale me karakter publik më afër qytetarit duke ulur në këtë mënyrë kostot e të mirave publike.

Më afër qytetarëve dhe bizneseve do të thotë dhe më shumë pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrje, si dhe më shumë transparencë dhe llogaridhënie në vendimmarrje politike të qeverive vendore. Nga miratimi i ligjit 115 në vitin 2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” u vendos që Shqipëria të ketë një ndarje të re territoriale e cila e ndan atë në dy nivele të njësive të qeverisjes vendore. Nga ndarja e re territoriale u vendos që të jenë 12 qarqe të cilët do të ndaheshin më tej në 61 bashki. Reforma territoriale e ndërmarrë nga qeveria shqiptare është një hap i parë drejt një reformimi të mëtejshëm të kompetencave të qeverive vendore në procesin e decentralizimit politik dhe fiskal.

Financat ndër qeveritare në Shqipëri janë të rregulluara nga një numër i madh ligjesh dhe aktesh nënligjore, më së shumti të rëndësishme janë: Ligji i ri "Për Vetëqeverisjen Lokale" dhe "Ligji për Sistemin Vendor të Taksave", Ligji i ri për Financat e Vetëqeverisjes Lokale, Ligji "Për

menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjet vjetore të buxhetit. Të hyrat vetanake rregullohen me Ligjin (SistemiLokaliTaksave).

Burimet e të ardhurave vetanake më të rëndësishme janë: taksa e pronës, taksa mbi ndikimin në infrastrukturë I ndërtimeve të reja dhe tarifatat lokale për shërbimet lokale. Tema e këtij punimi në epiqendër ka analizën e nivelit të decentralizimit fiskal në rastin e Shqipërisë në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në vecanti do të analizohet meaxhimi I financave publike në nivel të Bashkisë së Dibrës. Me konkretisht do të analizohet procesi I planifikimit dhe realizimit të buxhetit nga burimet vetiake dhe nga transferet dhe grantet qeveritare. Periudha e marrë në shqyrtim në këtë analizë do tejet nga viti 2016 deri në vitin 2020. Analiza e financave lokale të bashkisë së Dibrës do të ketë parasysh treguesit kryesor të decentralizimit fiskal në anën e të ardhurave dhe shpenzimeve fiskale të përcaktuara nga Nalas (2020).

2. Qëllimet e hulumtimit

Strukturat buxhetore të bashkive në Republikën e Shqipërisë rregullohet me ligje të posaçme për financimin e autoriteve lokale në bazë të ligjeve dhe akteve nën ligjore ku janë të definuara saktë burimet e financimit të bashkive dhe komunave ku përfshihen të ardhurat fiskale vetiake, grantet nga buxheti i qeverisë dhe nga buxhetet e fondeve të huaja dhe huamarja. Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të argumenton faktin se në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor Shqipëria ka nivelin më të ulët të decentralizimit fiskal dhe njëkohësisht në atë kuadër burimet vetiake të bashkive (komuna) përbëjnë nga 5-10% nga totali i financave publike lokale më të cilat bashkit qeverisen.

Analiza do të përqëndrohet në analizën e projeksioneve buxhetore dhe realizimeve buxhetore nëpërmjet analizës së pasqyrave buxhetore për bashkinë e Dibrës për periudhën 2016-2020, duke analizuar trendin dhe strukturën e realizimit të të ardhurave nga burimet vetiake dhe granteveve qeveritare dhe shpenzimeve operative ose fikse dhe shpenzimeve të deleguara ose transfereve që u bartën institucioneve tjera dhe qytetarëve.

Qëllimi specifik i këtij hulumtimi do të jetë të analizon nivelin e të ardhurave fiskale nga burimet vetiake në raport me totalin e të ardhurave fiskale në krahasim me vendet e BP në funksion të

argumentimit të faktit se bashkit-komunat e Shqipërisë kanë potencialin autonom më të vogël si rezultat i centralizimit të lartë të financave fiskale në Shqipëri.

Ky hulumtim krahas analizes pesëvjeçare (2016-2020) do të analizon në mënyrë specifike edhe vitin 2020 si vit i krizës financiare i shkaktuar nga Covid -19, për të parë se pse efektet negative nga kriza e Pandemisë nuk manifestohen në arketimin e të ardhurave fiskale nga burimet vetiake të bashkisë.

3. Hipotezat

H1: Decentralizimi fiskal në Republikën e Shqipërisë është në nivelin më të ulët në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor në veçanti në pjesën e të ardhurave fiskale autonome.

H2: Planifikimi dhe realizimi I të ardhurave nga burimet vetiake të bashkisë së Dibrës në periudhën e analizuar (2016-2020) lëvizën nga 4-10% të të ardhurave të përgjithëshme fiskale.

H3: Niveli shumë I ulët I të ardhurave fiskale autonome ka ndikuar që likuiditeti I buxhetit të bashkisë së Dibrës të ketë trendë rramës negativë për kundër trendit rritës të detyrimeve të papaguara.

H4: Covid-19 pandemia nuk ka pasur efekt përmbajtësor negativ në menaxhimin fiskal si në pjesën e të ardhurave dhe në pjesën e shpenzimeve buxhetore.

4. Metodologjia e hulumtimit

Metodat e përdorura në këtë punim do të jenë metoda kualitative, pra cilësore përmes të cilave sigurojmë kuptimin dhe sqarimin e sistemit buxhetor, strukturës së buxhetit dhe realizimit të buxhetit duke u fokusuar në Buxhetin e Bashkisë Dibrë. Të dhënat e grumbulluara do të jenë kryesisht sekondare nga buxheti I bashkisë së Dibrës dhe nga Ministria e financave me qëllim krahasimin e buxhetit dhe realizimin për periudhat që janë objekt I analizës dhe do të përdoren metoda kuantitative.

Gjithashtu do të përdoret metoda statistikore nëpërmjet preznetimit të tabelave dhe grafikoneve ku do të bëhet krahsimi I cdo viti dhe argumentimi për planifikimin dhe realizimin e Buxhetit të Bashkisë Dibrë në aspekt absolute dhe relative (%). Nuk përjashtohet mundësia e grumbullimit edhe të të dhënave primare nëpërmjet anketimit të stafit menaxherial dhe administrative të bashkisë së Dibrës dhe të qytetarëve dhe bizneseve kryesore në funksion të dhënies përgjigje me kompetente hipotezave të parashtruara.

Me anë të metodës së analizës dhe sintezës e cila do të realizohet nga informacionet e marrë nga dokumentet financiare të Bashkisë Dibrë, ministria e Financave e Shqipërisë dhe institucionet e tjera nacionale dhe ndërkombëtare në funksion të argumentimit të hipotezave të përcaktuara.

5. Rëndësia e punimit

Punimi synon të vlerëson nivelin real të decentralizimit fiskal në bashkin e Dibrës së një nga bashkit më të pazhvilluara në Republikën e Shqipërisë dhe të argumenton nevojën e rritjes së decentralizimit fiskal nëpërmjet transfereve në nivel bashkiat të më shumë parave publike që do të kishin orientim kryesor investimet kapitale dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Analiza e efektivitetit dhe efikasitetit në menaxhimin e parave publike në vecanti të transfereve dhe granteve qeveritare si para publike të cilat përbëjnë mbi 90% të të ardhurave publike dhe mbi 70% të shpenzimeve bashkiake në Dibrë në periudhën kohore (2016-2020) do të konstatojnë gjetje

meritore dhe do të jep rekomandime në cilat drejtime do të duhet të bëhen ndryshimet ligjore në perspektiv.

Bazuar në gjetjet e punimit bazuar në indikatorët fiskal të të ardhurave dhe shpenzimeve fiskale do të jipen rekomandime në funksion të një planifikimi më cilësor buxhetor dhe në veçanti në funksion të rritjes së arkëtimit të të ardhurave fiskale autonome.

Analizat preliminare nxjerin në sipërfaqe se menaxhimi fiskal I Bashkisë Dibrë përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19 në një kohë kur në shumë bashki kanë pasur rënje të të ardhurave fiskale në Bashkin e Dibrës nuk kemi ndryshime serioze negative në realizimin e arkëtimit fiskal nga burimet autonome dhe një kohësisht grantet qeveriatre janë arkëtuar në nivel maksimal.

Në përfundim duke u bazuar në të dhënat dhe informacionet e grumbulluara për buxhetin e Bashkisë Dibrë për periudhën kohore 2016-2020 do të arrihet në përfundime në lidhje me faktoret që kanë ndikuar në performancën e Bashkisë Dibrë përgjatë këtyre viteve, duke dhënë në fund edhe rekomandime dhe sygjerime për rritje të menaxhimit fiskal buxhetor si në anën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

2.Rishikimi I literatures

2.1Çfarë është decentralizimi fiskal ?

Decentralizimi është një proces gradual afatgjatë që përfshin, brenda një kuadri ligjor të përshtatshëm, komponentë të ndryshëm, si decentralizimi politik, decentralizimi administrativ dhe decentralizimi fiskal. Të tre komponentët janë të ndërlidhur me njëri tjetrin. Megjithatë, përzierja e përbërësve mund të ndryshojë dhe, rrjedhimisht situata mbizotëruese mund të ketë një paragjykim drejt dekoncentrimit ose transferimit.

Përfitimet e supozuara të decentralizimit lidhen me: parimin e subsidiaritetit, përmirësimi i qeverisjes, llogaridhënies, demokratizimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, rritja e efikasitetit në lidhje me ofrimin e shërbimeve. (Boschmann, 2009)

Decentralizimi fiskal nënkupton lirim të disa kompetencave tek organet e zgjedhura në nivel vendor, për të përcaktuar brenda fushave të caktuara të së drejtës mundësinë për të krijuar nivelin e tatueshëm për disa taksa të veçanta vendore, si dhe e drejta e përdorimit të këtyre të ardhurave sipas nevojave të komuniteteve përkatëse.

Arritja e efikasitetit ekonomik, barazia dhe stabiliteti makroekonomik, mund të konsiderohen ndër çështjet kryesore të decentralizimit fiskal. Decentralizimi fiskal mbulon dy çështje të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën: E para lidhet me shpërndarjen e burimeve dhe shpenzimeve në nivelet të ndryshme të qeverisjes. E dyta lidhet me pushtetin që i është dhënë pushtetit vendor për të përcaktuar të ardhurat dhe shpenzimet e tyre. (Dragusha & Osmani, 2012)

Decentralizimi fiskal në përgjithësi i referohet transferimit të taksave, shpenzimeve dhe kompetencat nga kontrolli i autoriteteve të qeverisë qendrore tek autoritetet qeveritare në nivele vendor. Në një sistem shumë të decentralizuar, qeveritë vendore kanë fuqi të konsiderueshme për të mobilizuar burimet, nëpërmjet autoriteteve tatimore të shoqëruara nga baza të forta tatimore. Në përgjithësi, transferimi i funksioneve dhe përgjegjësisë të shpenzimeve shkon së bashku ose pasohet nga dekoncentrimi i shërbimeve publike dhe zgjedhjeve lokale. Shumica vendeve në rrugën e decentralizimit fiskal kanë filluar të zhvillojnë një grup reformash ligjore duke përfshirë një kod tatimor, një ligj të ri buxhetor dhe një ligj të ri të thesarit. (Boschmann, 2009)

Caktimi i burimeve të të hyrave vetanake vendore nënkupton se cilat do të ishin të ardhurat që do të mbledhen nga bashkitë dhe çfarë proporcioni do të jetë transferta nga qeveria qendrore dhe cilat taksa do të shkojnë tërësisht si të ardhura të qeverisë.

Përcaktimi i përgjegjësisë për kostot nënkupton të cilat janë kosto ekskluzive për bashkitë, të cilat kanë funksione të deleguara nga qeveria qendrore dhe cilat janë ato kosto që do të mbulohen rëndom nga të dyja anët.

Transfertat fiskale ndërqeveritare shoqërohen gjithashtu me pikën e lart përmendur, sepse i referohet financimit të dhënë të njësisë vendore nga qeveria qendrore dhe të dhënë me kusht (transferim me kusht) ose për çdo nevojë që pushteti vendor ka (i pakushtëzuar). Huamarrja vendore është një tjetër opsion financimi. Qeveritë vendore gjithashtu mund të mbështeten në

këtë lloj të financimit, megjithëse barra për huamarrje do të bjerë përsëri në atë qeverinë qendrore.(Dragusha & Osmani, 2012)

Sipas Tiebout (1956) dhe Oates (1972) një autonomi më e madhe financiare ose më shumë transfertat e fondeve për nivelet e qeverisjes vendore do të sillte më shumë efikasitet në shpërndarje dhe përdorime të fondeve, si në prodhim, në rritjen ekonomike. Ka disa ambiente për një marrëdhënie pozitive midis decentralizimit fiskal dhe rritjes ekonomike.

Tiebout dhe Oates përkufizojnë, së pari, faktin se decentralizimi fiskal, si proces, nënkupton një mobilizim të burimeve financiare. Rrjedhimisht, pushtetet vendore, vetëm sepse kanë më shumë autonomi, do të shtyhen për të mobilizuar burimet e tyre financiare në vend që të presin zgjidhjet e problemeve apo sigurimin e të mirave publike vendore nga pushteti qendror. Në këtë mënyrë ata përdorin burimet lokale që përndryshe do të mbeteshin të pashfrytëzuara.

Decentralizimi fiskal është kalimi i autoritetit buxhetor, nga qeveria qendrore, në qeveritë lokale, dhe kompetenca materiale për të vendosur, për taksimin dhe shpenzimet. Decentralizimi fiskal nuk është identik me dekoncentrimin e vendim-marrjes dhe ushtrimin e kompetencave të institucioneve e agjensive ligj zbatuese qeveritare, nga njësi të qeverisjes vendore. Decentralizimi fiskal nuk duhet ngatërruar as me delegimin e kompetencave nga institucione e agjensi qeveritare, në shpërndarjen e shërbimeve në grupet e interesit në komunitet.

Decentralizimi fiskal përbën dimensionin financiar të decentralizimit që u jep autoritet organeve përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore të miratojnë buxhete të pavarura të bazuara kryesisht në të ardhurat e veta, transfertat e deleguara dhe donacione të legjitimuara, dhe të balancuar me shpenzimet që garantojnë qeverisje demokratike dhe shërbime publike të standardeve më të përparura, për komunitetet që i kanë zgjedhur.

2.2 Progresi i decentralizimit fiskal në Shqipëri

Organet e qeverisjes vendore në Shqipëri praktikisht nuk kishin autonomi apo autoritet ndërmjet viteve 1944 dhe 1992. Kuadri kushtetues i vitit 1944 përfshinte organet vendore qeveritare në piramidën e pushtetit shtetëror, por në praktikë kishte ekstreme centralizimin e funksioneve ekzekutive, pa vendor politik, fiskal apo administrative autonomi. Funksionet, të ushtruara nga pushtetet vendore, ishin thjesht një shtrirje të politikave shtetërore qendrore dhe procedurave të vendimmarrjes. (Hoxha,2002)

Reformat drejt decentralizimit u ndërmorën pas fillimit të tranzicionit të Shqipërisë drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut të lirë në fillim të viteve 1990 dhe u rrit pas nënshkrimit nga Shqipëria të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale në 1998. Standardet kryesore në procesin e transferimit të Shqipërisë deri më sot janë në vijim:

- 1992, Gusht –Miratimi i Ligjit për Funksionet dhe Organizimin e Pushtetit Lokal. Autoritetet lokale politikisht-autonome u krijuan për herë të parë. Disa shërbime dhe funksione iu kaluan nivelit vendor, por nuk kishte autonomi reale administrative apo fiskale. Ishte ende e vështirë për të bërë një dallim përgjegjësitë ndërmjet pushteteve lokale dhe kombëtare në atë kohë dhe të iniciativa e autoriteteve vendore ishte shumë e kufizuar. Kishte mospërputhje serioze ndërmjet përgjegjësive të ndara dhe autoritetit për të vepruar, autonomisë së ulët fiskale, dhe pjesëmarrja demokratike e komuniteteve lokale u dëmtua rëndë.
- 1992, shtator – Miratohet Ligji për zgjedhjet për pushtetin lokal, i cili përcakton parimet e organizimit, sistemi i zgjedhjeve dhe autoritetet mbikëqyrëse.
- 1993 – Miratohet ligji për buxhetet vendore. Autonomia financiare e autoriteteve vendore mbeti shumë i kufizuar – 95% e buxheteve vendore garantoheshin nga buxheti I shtetit.
- 1997 – Miratohet vendimi nr. 204 i Këshillit të Ministrave, që përcakton aktivitetet dhe institucionet që do të merren nga pushteti vendor dhe ndryshimi I mënyrave të financimit. Fondet për mirëmbajtjen e institucioneve të transferuara nga buxheti i shtetit për çdo

qeverisje vendore, duke lejuar autoritetet vendore të përcaktojnë ato prioritetet dhe shpenzimet e veta.

- 1998, tetor – Kuvendi i Shqipërisë ratifikon Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore.
- 1998, Nëntor - Kushtetuta shqiptare e sapomiruar parashtron parimet e decentralizimit, ku thuhet se “Parimi i decentralizimit të pushtetit është parimi bazë mbi të cilin është e ndërtuar qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë”.
- 1999 – Komiteti Kombëtar për Decentralizim i themeluar nga qeveria.
- 1999, Nëntor – U miratua Strategjia për Decentralizim me qëllim të zbatimit të dispozitat kushtetuese për decentralizimin.
- 2000, Korrik – Ligji për Ndarjen Territoriale- Administrative të Pushtetit Lokal Njësitë në Republikën e Shqipërisë dhe për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisë Vendore miratoi krijimin e dy niveleve të qeverisjes vendore shqiptare – Rajonet dhe Bashkitë.
- 2003, Qershor – Miratimi i Kodit të Ri Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton kufijtë dhe procedurat zgjedhore për zgjedhjen e zyrtarëve të pushtetit vendor. (Hoxha,2002)

Vitet e fundit Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në përcaktimin e zhvillimit të politikave për decentralizimin. Në korrik 2014, Kuvendi i Shqipërisë shënoi hapin e parë drejt Reformës Territoriale dhe Administrative me miratimin e ligjit “Për administrative-territoriale ndarjet e njësive të qeverisjes vendore”, nga ky ligj u vendos që të ishin vetëm 61 bashki të mëdha nga 373 komuna dhe bashki që ishin me parë. Duke pasur një numër më të vogël të njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri, qeveria ka mundësi për të forcuar kapacitetet e qeverisjes vendore.(Nalas, 2018)

Pas Reformës Territoriale dhe Administrative, një sërë pasojash ligjore dhe ndryshimet institucionale ndodhën ndërmjet 2015 dhe 2017

- Zgjedhjet vendore u zhvilluan në qershor 2015 dhe 61 kryetarë bashkish morën detyrën në bashkitë e reja të krijuara.

- Strategji e re Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore u miratua në mesin e vitit 2015, duke ofruar një udhërrëfyes për të rritur decentralizimin dhe forcimin e qeverisjes vendore.
- Ligji i ri për Vetëqeverisjen Lokale u miratua në dhjetor 2015, konsolidimin e organizimit dhe funksionimit të pushteteve të reja vendore, por edhe rritjen e tyre përgjegjësitë duke decentralizuar një numër të reja dhe funksione të kushtueshme si (mbrojtja nga zjarri, ujëjtja, pagat e mësuesve parashkollorë dhe sociale qendrat e shërbimit).
- Një formulë e re e grantit të pakushtëzuar u miratua në Buxhetin e vitit 2016 Ligji për ndarjen e granteve për pushtetin vendor në mënyrë më transparente, të barabartë dhe të parashikueshme.
- Ligji i ri për Financat e Vetëqeverisjes Lokale është miratuar në prill 2017, duke konsoliduar Rishikimet e Decentralizimit Fiskal dhe në të njëjtën kohë rritjen e disiplinës fiskale vendore.
- Ndërmjet 2017 dhe në fillim të vitit 2018 ishte një reformë e re e tatimit mbi pronën.

Financat ndërqeveritare në Shqipëri janë të rregulluara nga një gamë e gjerë ligjesh dhe aktesh nënligjore. Kuadri ligjor përcakton katër lloje të transfertave: taksa të përbashkëta, transfertat të pakushtëzuara, transfertat specifike, transfertat e kushtëzuara për funksionet e deleguara dhe investimi i kushtëzuar nga Fondi i Zhvillimit Rajonal.

Të hyrat vetanake rregullohen me Ligjin për Sistemin e Taksave Vendore. Burimet e të ardhurave vetanake më të rëndësishme janë: tatimi periodik i pronës, taksa mbi ndikimi në infrastrukturë i ndërtimeve të reja dhe tarifatat për shërbimet lokale. Deri kohëve të fundit, ishte edhe Taksa e Biznesit të Vogël një burim kryesor përcaktues për pushtetin vendor. Për fat të keq, që nga viti 2006, baza e Taksës së Biznesit të Vogël ka qenë reduktuar në mënyrë të përsëritur dhe në periudhën 2013-2015, në praktikë ajo u shndërrua në një taksë të përbashkët që tani mblidhet nga qeveria kombëtare nga të cilat shumica dërrmuese e bizneseve të vogla përjashtohen. Rendimenti i Taksës së Biznesit të Vogël në 2017 është vetëm 10% e asaj që njësitë vendore grumbulluan në vitin 2008. Eliminimi i Taksës së Biznesit të Vogël përkoj me paqëndrueshmërinë në rënie të ndërtimeve të reja dhe të një imponimi nga qendra moratorium për lejet e reja të ndërtimit derisa

pushteti vendor të miratojë Planet e Përgjithshme Vendore të Territorit. Qeveritë vendore iu përgjigjën rënies së të ardhurave nga Taksa e Biznesit të Vogël dhe Lejet e Ndërtimeve të reja duke përmirësuar administrimin e taksës periodike të pronës. Në fakt, rendimenti i tatimit në pronë u rrit nga 0.18% e PBB-së në 2013 në 0.27% të PBB-së në 2017. Tatimi në pronë aktualisht përfaqëson 21% të të hyrave vetanake dhe rreth 7% të të hyrave totale.(Nalas, 2018)

Qeveria kombëtare ka nisur së fundmi reforma për të zgjeruar bazën e taksës, për të vendosur një kadashtër të pronave të menaxhuara në nivel kombëtar dhe të zhvendosni vlerësimin tatimor më pranë një vlere tregu. Si rezultat, në vitin 2018, baza e Taksës së pronës për ndërtesat urbane është dashur të jetë në vlerën e tregut të ndërtesës, e vlerësuar sipas disa rregullave të vendosura nga qeveria kombëtare. Shkalla e tatimit u vendos në 0.05% të vlerës së vlerësuar për familjet dhe 0.2% të vlerës së vlerësuar të godina për biznese. Për shkak të vështirësive teknike, shumica e qeverive vendore vazhduan të vendosin pagesa të njëpasnjëshme për taksën e pronës.

Aktualisht pushtetet vendore shqiptare vuajnë nga tre dobësi kryesore strategjike. Së pari, një kuadër i dobët ligjor që krijon konfuzion mbi kompetencat reale të taksave dhe tarifave të qeverive vendore nga përcaktimi i bazës dhe normës për vlerësimin, mbledhjen dhe zbatimin. Së dyti, praktika e shpeshtë ndryshimi dhe reduktimi i kompetencave tatimore vendore, pa asnjë formë konsultimi ose kompensimi efektiv ka ulur përpjekjet tatimore dhe ka dekurajuar çdo investim serioz nga pushteti vendor në të mbledhjes. Së treti, për shkak të investimeve të pamjaftueshme nga qeveritë kombëtare dhe lokale në infrastrukturën teknike, rregullatore dhe politike, tatimi në pronë është nënshfrytëzuar.

Dobësi kryesore këtu është mungesa e një regjistri gjithë përfshirës që lidh pronat me tatimpaguesit dhe pothuajse mungesë e plotë e bashkëpunimit ndërmjet qendrës qeveritare përgjegjëse për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe pushtetit vendor edhe pse kuadri ligjor sanksionon që të parat duhet t'u japin Njësitë Qeverisëse Vendore informacionin që kanë për pronat e regjistruara. Mungesa të kadastrës fiskale dhe pamundësisë për të bashkëpunuar ndërmjet institucioneve publike ka çuar në performancë të dobët në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Decentralizimi fiskal shpreh se sa qeveritë vendore janë të mbështetura me autoritet, me kompetenca dhe legjislacion për përdorimin dhe menaxhimin e burimeve financiare, për sigurimin e shportës të shërbimeve lokale për të cilat ato janë përgjegjëse, për nivelin e taksave dhe të ardhurave lokale, dhe burimet grant me të cilat ato financojnë shpërndarjen e shërbimeve publike lokale. Për përfitime të plota të decentralizimit fiskal dhe rezultate të qëndrueshme për komunitetet lokale, është e domosdoshme të mbahen parasysh lidhjet që vendosen mes decentralizimit fiskal, me decentralizimin politik dhe administrativ.

2.3 Decentralizimi fiskal dhe matja e treguesëve të tij.

Aktualisht, decentralizimi fiskal është bërë çështja kryesore për ekonomistët dhe qeveritë për dekadat e fundit, në përgjigje të nxitjes në krijimin e një qeverije dhe qeverisje të mirë në vende të ndryshme të botës. Decentralizimi fiskal përfshin elementë që harmonizojnë autonominë buxhetore. Autonomia buxhetore nënkupton masën e shpenzimeve të veta në termat e shërbimeve dhe të mirave publike bazuar në nevojat e komunitetit lokal. Kurse autonomia e të ardhurave lokale nënkupton që qeveria lokale ka autoritetin dhe përgjegjësinë e vet në vendimmarrje lidhur me burimet për financat e tyre. Autonomia lokale buxhetore rezulton kur qeveria lokale dëshiron të administrojë shkallën e të ardhurave në raport me nivelin e shpenzimeve.

Parimisht një decentralizim fiskal i suksesshëm, shkon në harmoni me decentralizimin politik dhe administrativ. Kjo do të thotë që qeveritë lokale duhet të jenë politikisht të mbështetura nga zgjedhjet demokratike dhe këshillat përfaqësuese lokale, duhet të jenë në gjendje t’i mbajnë qeveritë e tyre lokale të përgjegjshme. Ato duhet të kenë kontrollin mbi shërbimet, të kryejnë funksionet e tyre në një mjedis mbështetës për zhvillimin e kapacitetit të tyre, për forcimin e sistemeve përfshirëse për menaxhimin e shpenzimeve publike, dhe mekanizmat e përgjegjshmërisë. Decentralizimi fiskal konsiderohet i suksesshëm, kur realizon një dialog mirëkuptues, midis qeverive lokale dhe qeverisë qendrore, kur ka legjislacion që stimulon e gjeneron të ardhura për taksat paguesit, por edhe krijon institucione transparente për menaxhimin e taksave të qeverisjes lokale.

UNDP (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim) mendon se decentralizimi fiskal mbulon një fushë të gjerë, prandaj ai mund të analizohet në kuadrin e elementëve apo “shtyllave” që përcaktojnë kompetencat për caktimin e të ardhurat nga taksat dhe burime të tjera ligjore, të shpenzimeve lokale të planifikuara me metoda bashkëkohore, të transfertave apo granteve për qeveritë lokale nga qeveria qendrore, dhe huamarrjes nga qeveritë lokale për të financuar mungesat e të ardhurave. (UNDP, 2005)

Shqipëria ka arritur në decentralizimin fiskal, ashtu si ka edhe mjaft boshllëqe. Decentralizimi fiskal ose transferimi i përgjegjësiave për të ardhurat dhe shpenzimet në nivele vendore, ka mbetur më prapa decentralizimit politik i cili realizon transferimin e pushtetit vendimarrës tek organet e zgjedhura përfaqësuese dhe ekzekutive të tyre në nivel lokal, dhe pas decentralizimit administrativ që transferon funksione të veçanta publike dhe të shërbimeve, nga pushteti qendror në organet e pushtetit lokal.

Reforma e viti 1992 krijoi mundësinë për kalimin e organizimit të pushtetit lokal nga modeli i centralizuar i para vitit 1990 në modelin e decentralizuar dhe vetëqeverisës më pas, përmes ndarjes së re administrative-territoriale, zgjedhjeve pluraliste dhe kompetencave të reja për njësitë vendore por nuk mund të flitej për “autonomitë vërtetë administrative e sidomos fiskale”.(Kurti, 2018)

Studjues të decentralizimit fiskal argumentojnë se përcaktimi i shpenzimeve përbën gurin e themelit të sistemit buxhetor, prandaj hartimi i sistemit buxhetor duhet të filloj me përcaktimin e shpenzimeve, dhe më pas, financa do të ndjekë funksionin.(Bahl, 2008)

Sipas Bankës Botërore, decentralizimi fiskal ndodh përmes mekanizmave të ndryshëm, ku përfshihen, vetë financimi lokal, bashkë financimin, taksat lokale, transfertat monetare nga qeveritë qendrore dhe huatë bashkiake. Rëndësi teorike dhe praktike merr teza se si matet decentralizimi fiskal ? Pasi përvoja në vende të ndryshme tregon, se shumë studime për matjen e decentralizimit fiskal dështojnë, pasi ka mangësi në të dhënat në nivel lokal. Prandaj vendosja e një standarti për të matur progresin në mbarë botën është hapi drejt përpjekjeve decentralizuese.

Në një raport të publikuar më 2012 të titulluar “Sa afër është qeveria e juaj ndaj popullit” (How Close is Your Government to Its People), Banka Botërore jep alternativa mbi matjen e decentralizimit fiskal nëpërmjet disa instrumenteve fiskale, si, hendeku fiskal vertikal, autonomia e taksimit, transfertat e pa kushtëzuara të qeverisë lokale, e shpenzimeve dhe liria e huamarrjes. Këta tregues mundësojnë krijimin e një metodologjie matje, duke siguruar të dhëna të sakta. (Ivanyna & Shah, 2012)

Burimi më i mirë për të analizuar lëvizjet fiskale janë Statistikat Financiare Qeveritare të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të cilat sigurojnë të dhëna dhe japin përkufizime të qëndrueshme. Statistikat ofrojnë të dhëna për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e decentralizimit fiskal. Standardizimi i të dhënave fiskale është pika më e rëndësishme e GFS që mbulon 149 vende, dhe është burimi i vetëm që ofron të dhëna të sakta. Aspekti më i rëndësishëm i decentralizimit fiskal, është autonomia e të ardhurave e qeverive lokale, pasi decentralizimi fiskal, në kuptimin e tij më të qartë, shfaqet në shkallën e autonomisë që kanë njësitë e qeverisë lokale për financimin e të mirave dhe shërbimeve publike në juridiksionet përkatëse.

Studiuesi Chanchal Kumar Sharma ofron dy metoda për të matur autonominë fiskale. Njëra i jep rëndësi evoluimit të autoritetit taksor, si një instrument i decentralizimit që i shërben autonomisë lokale, metoda tjetër i jep më shumë peshë llojit të transfertave ndërqeveritare, të kushtëzuara ose jo, si një instrument që ndikon mbi sjelljet lokale dhe ndikon në autonominë dhe përgjegjshmërinë e tyre. Sharma, raportin e të ardhurave me shpenzimeve lokale, e konsideronsi instrumentin fiskal të mënyrës statistikore për matjen e decentralizimit fiskal, pasi instrumentet rregullatore dhe financiare janë shumë më komplekse për ta matur atë. (Sharma, 2004)

Manuali i Statistikave Financiare Qeveritare të Fondit Monetar Ndërkombëtar përdoret për përgatitjen e vjetarit statistikor që siguron drejtimin metodologjik për hartuesit e statistikave financiare qeveritare, analistët fiskalë, dhe përdoruesit e tjerë të të dhënave fiskale. Manuali krijon një kuadër konceptual dhe shërben për analiza dhe vlerësimin e politikës fiskale. The Organization for Economic Cooperation and Development (OECD) është angazhuar në studime të decentralizimit fiskal të vendeve dhe për rolin e shpenzimeve, të ardhurave dhe transfertave fiskale ndërqeveritare. Një nga mjetet metodologjike kryesore të OECD është Ankëtimi i Projektit Fiskal (Fiscal Design Survey 2011). Ankëtimi shqyrton të katër komponentë të marrëdhënieve: Të ardhurat lokale, shpenzimet lokale, kuadrin institucional dhe marrëdhëniet fiskale.

Në dallim nga metodologjitë e FMN-së, anketa përmban, si dimensionet cilësore edhe ato sasore. Ankëtimet cilësore merren me strukturën e transfertave ndërqeveritare dhe rolin në autonominë lokale për shpenzimin e fondeve të tilla. Në fokus janë transfertat e granteve, kufizimet mbi shpenzimet dhe roli i decentralizimit fiskal në reformat e decentralizimit. Duke u bazuar në të dhënat e detajuara të ankëtimeve, OECD ka ndërtuar një bazë të dhënash me tregues të decentralizimit fiskal nga vëndet anëtare për vitin 2009. Në database janë treguesit bazë fiskal, transfertat ndërqeveritare, dhe struktura e të ardhurave. Treguesit bazë përfshijnë ndarjet tipike të të ardhurave dhe shpenzimeve lokale, me qiratë, huamarrjen, shpenzimet, të ardhurat, të ardhurat nga taksat, dhe tarifatat e përdorimit. Metoda ankëtuese përdor pyetje të standartizuara, por, disa nga përgjigjet mund të jenë subjektive dhe mund të jetë e vështirë për ti krahasuar. (Abdelhak 2012)

Metodologjia e mbledhjes të të dhënave duhet të përfshijë si treguesit e decentralizimit fiskal, sasior dhe cilësor, ku përfshihet struktura bazë e qeverisjes të sektorit publik lokal, struktura fiskale e sektorit publik dhe masat cilësore të institucioneve dhe proceseve politike, administrative dhe fiskale në nivel lokal. Në finale treguesit që shprehin nivelin e decentralizimit fiskal, janë të ardhurat e shpenzimet lokale, në raport me të ardhurat e shpenzimet publike, të ardhura e shpenzime lokale në raport me PBB, struktura e të ardhurave e shpenzimeve të vetëqeverisjes lokale dhe raporti midis të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit lokal si një tregues i përputhshmërisë të burimeve financiare me kompetencat e vetëqeverisjes lokale etj.

2.4 Ndikimi i decentralizimit fiskal në zhvillimin ekonomik

Shumica e teorive mbi decentralizimin fiskal argumenton për një lidhje pozitive midis decentralizimit fiskal dhe rritjes ekonomike. Madje shumë studime tregojnë se suksesi i

proceseve të decentralizimit është pasojë e jo vetëm hartimit të modelit të decentralizimit, por, ndoshta më e rëndësishmja, të karakteristikave të vendit dhe veçanërisht të ekzistencës së institucioneve të fuqishme efektive në nivelet qeveritare (Dabla-Norris, 2006).

Ky mund të jetë një shpjegim pse decentralizimi fiskal duket se ka rezultate më të mira në vendet e zhvilluara dhe më pak sukses në vendet që janë në zhvillimin e tyre. Në përgjithësi, literatura mbi lidhjen ndërmjet decentralizimit fiskal dhe rritjes ekonomike mund të rreshtohet në dy kampe të kundërta: ato që priren të nxjerrin në pah lidhjet pozitive midis të dy faktorëve dhe atyre që qëndrojnë në aspektet negative.

Argumentet në favor të decentralizimit fiskal, të përqendruara fillimisht rreth punimeve e Tiebout (1956), Musgrave (1958) dhe Oates (1972), pretendojnë se promovon më shumë efikasitet, shërbim publik më i mirë, transparencë më e madhe dhe përfundimisht, rritje ekonomike.

Së pari, shpesh argumentohet se decentralizimi rrit efikasitetin ekonomik sepse qeveritë vendore janë më të pozicionuara se qeveria kombëtare për të ofruar shërbime publike si rezultat i afërsisë dhe avantazhit informativ. Kjo afërsi është veçanërisht e rëndësishme në vendet me të ardhura të ulëta ose tregjet në zhvillim ku, në mungesë të mundësive të tregut popullatat mbështeten shumë në veprimet shtetërore për mbijetesën e tyre (Besley dhe Burgess, 2002).

Së dyti, shpenzimet e decentralizuara mund të çojnë në 'efikasitet konsumator' më të madh. Meqenëse kërkesat janë të ndryshme në secilin territor, burimet mund të kursehen duke diversifikuar rezultatet e qeverive në përputhje me kërkesat lokale. Lëvizshmëria e popullsisë dhe konkurrenca ndërmjet qeverisjes lokaleve dhe qeverisjes qendrore për ofrimin e shërbimeve publike sigurojnë përputhjen e preferencave ndërmjet komuniteteve lokale dhe qeverive lokale kështu qeveritë konsiderohen të jenë më të pajisura për të ofruar një shërbim më të përshtatshëm për popullsinë lokale sesa qeveritë qendrore. Kështu, decentralizimi mund të përmirësojë jo vetëm potencialin për arritjen e efikasitetit Pareto, por edhe për arritjen e barazisë më të madhe ekonomike në të gjithë territoret (Ezcurra dhe Pascual 2008).

Së treti, decentralizimi ka të ngjarë të nxisë konkurrencën horizontale dhe vertikale në nivel lokal dhe rajonal, duke i detyruar qeveritë të përqendrohen në prodhimin efikas të të mirave publike dhe shërbimet dhe kufizimi i kapacitetit të burokratëve për të vepruar si maksimizues të të ardhurave (Thiessen, 2003).

Kohët e fundit, disa kanë argumentuar se decentralizimi mund të shërbejë gjithashtu për ruajtjen dhe promovimin e zhvillimit të tregjeve. Weingast (1995) dhe McKinnon (1997) sugjerojnë këtë aranzhimet fiskale ndërqeveritare të strukturuar në mënyrë të përshtatshme mund të krijojnë mjaftueshëm stimuj për qeveritë nënkombëtare për të nxitur tregjet. Për më tepër, nëse qeveria qendrore është një burim i joefikasitetit të politikave, decentralizimi mund të përmirësojë alokimin e burimeve, nxitja e zhvillimit të tregut dhe nga ana tjetër nxitja e rritjes ekonomike (Martinez-Vazquez & McNab, 2003).

Së fundi, decentralizimi fiskal shpesh shihet si një mjet për rritjen e pjesëmarrjes demokratike në procesin e vendimmarrjes, duke lejuar transparencë dhe llogaridhënie më të madhe. Në ndryshim nga këto argumente, një gamë e gjerë studimesh tregojnë se decentralizimi rrallë, nëse ka përmbushur pritshmëritë. Disa studime madje e konsiderojnë të dëmshme, veçanërisht në rastin e ekonomive që janë në zhvillim dhe në tranzicion (Rodden, 2002).

Ky skepticizëm ushqehet nga problemet që shpesh lidhen me decentralizim, si rritja e deficiteve, cilësia më e ulët e qeverisjes vendimtare, korrupsioni, rritja e ndikimit të grupeve të interesit, e më shumë pabarazitë ndër rajonale, të cilat mund të rezultojnë në një rritje të përgjithshme ekonomike më të ulët. Shpesh ndodh që qeveritë e shkujdesura nënkombëtare kanë krijuar deficite të paqëndrueshme dhe u bëri thirrje qeverive qendrore të marrin përsipër detyrimet e tyre dhe në disa rastet ofrojnë transferta të veçanta shpëtimi, (Rodriguez-Pose & Gill, 2003).

Studimet e fundit kanë tentuar të zbulojnë se rritja e deficiteve nënkombëtare çon në nivele më të larta shpenzimet e qeverisë dhe borxhit së bashku me normat më të larta të inflacionit . Ky është veçanërisht shqetësues në rastin e zbatimit të shpejtë të decentralizimit në pjesë të Evropës Qendrore dhe Lindore. Është gjithashtu e vështirë për qeveritë të zbatojnë stabilizimin

makroekonomik në korniza të decentralizuara, për shkak të 'rrjedhjeve' të konsiderueshme ekonomike që lidhen me shpenzimet lokale (Martinez-Vazquez & McNab, 2003).

Siç prirjen të jenë demokracia lokale dhe llogaridhënia politike vulnerabël në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion, shpërndarjen e burimeve dhe shërbimet publike konsiderohen të jenë në rrezik më të madh nga korrupsioni dhe sjelljet oportuniste në nivelet më të ulëta të qeverisjes. Decentralizimi fiskal gjithashtu mund të përforcojë pabarazitë rajonale në dëm të rritjes së përgjithshme ekonomike (Rodriguez-Pose & Gill, 2004).

Prud'homme (1995) argumenton se duket se ekziston një masë kritike të ardhurash, popullsie dhe aktiviteti ekonomik mbi të cilin mund të realizohen përfitimet e decentralizimit. Ndërsa natyra dhe shtrirja e decentralizimit deri më sot është formësuar gjerësisht e matur nga realitetet politike, historike dhe etnike, efektiviteti i saj ndikohet nga dizajni dhe kapacitetet institucionale në të gjitha nivelet e qeverisjes. Zbatimi i decentralizimit fiskal në mënyrë të suksesshme kërkon praninë gjithëpërfshirëse të kuadrit institucional dhe në ekonomitë në zhvillim, ku institucionet janë ende në fazat e hershme të zhvillimit, duke u dizajnuar të suksesshëm politikat e decentralizimit kanë rezultuar të vështira. Në rastin e vendeve të Evropës lindore dhe qendrore kombinimi i përpjekjeve që synojnë arritjen makroekonomike stabilizimi, së bashku me ndryshimet strukturore themelore në ekonomi dhe konfliktet politike dhe etnike, kanë krijuar një mjedis jashtëzakonisht kompleks për decentralizimin fiskal. Një sfidë kryesore për këto ekonomitë në tranzicion ka qenë që të korrin përfitimet ekonomike të decentralizimit ndërsa ruajtjen e kontrollit mbi shpenzimet publike dhe huamarrjen, rivendosjen e rritjes dhe përmirësimi i përgjegjshmërisë së pushteteve vendore.

2.5 Pushteti qendror në Shqipëri

Sistemi administrativ në Shqipëri përbëhet nga të gjitha organet e administratës shtetërore, si ato që përmenden në Kushtetutën e Shqipërisë edhe ato organe të cilat nuk përmenden në kushtetutë por që i kanë të gjitha veçoritë juridike të organeve administrative.

Organet administrative sipas vendit që zënë në këtë sistem administrative ndahen në: organe të pushtetit qendror të cilët qëndrojnë në hallkat më të larta të këtij sistemi, organe të pushtetit vendor të cilat janë hallkat e mesme dhe kemi organet e bazës që janë hallka më e ulët e sistemit administrative.

Në organet e pushtetit qendror që janë edhe hallka më e lartë e aparatit administrativë në Shqipëri përfshihen: Këshilli I Ministrave dhe organet qendrore të specializuara të administratës shtetërore.

Këshilli I Ministrave ose Qeveria është organi më i lartë ekzekutiv udhëheqës në Shqipëri dhe qëndron në bazë të të gjithë organeve të pushtetit ekzekutiv të administratës tonë publike. Ai formohet nga organi më i lartë i pushtetit legjislativ që është Kuvendi ose Parlamenti dhe e gjithë veprimtaria e tij ekzekutive dhe vendimarrëse është e zhvilluar në bazë dhe në zbatim të akteve juridike të organit më të lartë të pushtetit shtetëror që domethënë në bazë dhe në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve.

Përveç Këshillit të Ministrave i cili thahet që është organi më i lartë urdhërdhënës në Shqipëri kemi edhe organe të tjera të pushtetit qendror në sistemin e aparatit administrative të shtetit tonë, të cilësuarat të specializuara të administratës shtetërore. Në ndryshim me Këshillin e Ministrave, këta janë organe me kompetenca të posaçme që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre vetëm në një ose disa degë apo fusha të caktuara të administratës publike.

Organe të tilla në sistemin tonë administrativ janë: Ministri, Drejtuesit e Institucioneve të tjerë qendrore të administratës shtetërore, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Avokati i Popullit, Drejtori i Shërbimeve Informative Shtetërore, Inspektori i Përgjithshëm i cili ndodhet në

Inspektoriatin e Lartë për Deklarimet dhe Kontrollat e Pasurive, Avokati I prokurimeve.(Dobjani, 2007)

2.6 Pushteti vendor në Shqipëri

Me pushtet vendor kuptojmë të drejtën që kanë njerëzit e një bashkësie të caktuar territorial që të qeverisin punët e tyre në mënyrë të pavarur, nëpërmjet organeve të cilat I zgjedhin vetë ose në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pushteti vendor ofron qeverisjen duke qenë sa më afër shtetasve nëpërmjet respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të cilat janë të sanksionuara në Kushtetutë, ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, njohjen së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë, zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë, realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore. Në Shqipëri kjo realizohet në bazë të parimit të autonomisë vendore dhe parimit të decentralizimit.

Parimi I Autonomisë vendore shpreh aspektin e vet më të dukshëm në përcaktimin e qartë të kompetencave të njësive të qeverisjes vendore, të cilat janë të parashikuara në Kushtetutë dhe në bazë të ligjit, për të vendosur vetë për ato probleme që hyjnë në juridiksionin e tyre.

Një rëndësi të vecantë paraqet përcaktimi I kompetencave drejtpërdrejtë në Kushtetutë, sepse kjo do ta bënte të pafuqishme prirjen e ekzekutivit për iniciativ ligjore përpara ligjvënësit për ndryshime ligjore në cdo kohë. Një gjë e tillë garanton qëndrueshmërinë e kompetencave të pushtetit vendor, prandaj statusi kushtetues I qeverisjes vendore ka si rezultat kryesor pavarësinë e saj. (Haxhimali, 2019)

Parimi i decentralizimit I referohet transmetimit të përgjegjesive apo funksioneve shtetërore dhe kombëtare nga pushteti qendror tek pushteti vendor .Decentralizimi mund të cilësohet si ripërcaktimi I strukturave, procedurave dhe praktikave të qeverisjes për të qenë më afër me qytetarët.Decentralizimi mund të marrë disa forma. Dekoncentrimi, delegimi dhe transferimi janë format kryesore të decentralizimit. (Miller, 2002)

Dekoncentrimi, që shpesh herë quhet edhe decentralizim administrativ ose burokratik, është termi që përdoret kur decentralizimi merr formën e transferimit të funksioneve nga pushteti qendror në atë vendorë, pasi vendimmarrja reale mbahet në qendër.

Delegimi ka të bëjë me dërgimin e përgjegjësive dhe autoritetit për kryerjen e funksioneve të caktuara nga pushteti qendror në institucione ose agjensi shtetërore të cilat janë të vendosura në nivel lokal. Nga kjo arrijmë të kemi një nivel kontrolli të lartë nga zyrat qendrore në atë vendore.

Transferimi është një tjetër formë e decentralizimit e cila ka të bëjë me transferimin e autoritetit dhe përgjegjësive nga pushteti qendror në atë të pushtetit vendor. Këto pushtete dhe organet përkatëse të tyre janë institucione krejtësisht të pavarura dhe legjitime nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore dhe përfaqësojnë nivele të ndryshme të qeverisjes. (Haxhimali, 2019)

Çdo komunitet ka mundësitë, atributet dhe potencialet e veçanta për të rritur apo ulur shanset për një sukses të zhvillimit ekonomik. Një gjë e tillë arrihet në bazë të formës mënyrës, qasjeve në proces nëpërmjet bashkëpunimit gjithëpërfshirës. Është kjo arsyeja që programet sektoriale zhvilluese, programet e bizneseve të veçanta etj., duhet të arrihen të përfshihen, në një mënyrë apo në një tjetër në atë plan të përbashkët që bën të mundur bashkërendimin e kontributeve të veçanta në zhvillimin e përgjithshëm të komunitetit. Po ashtu është kjo arsyeja që hartimi i një plani për zhvillimin e komunitetit është tepër i nevojshëm dhe pa të nuk i shërbehet prespektivës. (Swinburn, 2006)

2.7 Mardhëniet midis pushtetit qendror me pushtetin vendor në Shqipëri

Mardhënia midis pushtetit qendror dhe atij vendor parashikohet në Kushtetutën e Shqipërisë në ligjin nr.139/2015 në kreun e katërt. Mardhëniet e këtyre dy pushteteve rregullohen në bazë të parimeve kryesore të cilat janë: parimin e subsidiaritetit, të bashkëpunimit dhe të konsultimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta. Sa më lartë të jetë bashkëpunimi midis institucioneve të qeverisjes qendrore me organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore, aq më efektive dhe efikase do të jetë qeverisja për tu dhënë zgjidhje problemeve të qytetarëve.

Organet e njësisve të pushtetit vendor duhet që të vejnë në dijeni me shkrim organet e pushtetit qendror për të gjitha çështjet që u kërkohet informacion dhe që janë në përgjegjësinë e tyre. Gjithashtu edhe organet e pushtetit qendror u japin informacion organeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore, sipas afateve që janë të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Organet e qeverisjes qendrore konsultohen në njësitë e vetëqeverisjes vendore në lidhje me politikën, legjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në zbatimin e të drejtave dhe funksioneve të këtyre njësisve.

Organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore konsultohen, në lidhje me legjislacionin dhe politikën të cilat kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në zbatimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre, nga ana e disa shoqatave të cilat janë krijuar për këtë qëllim specifik dhe përfaqësojnë pushtetin vendor dhe grupe të tjera të interesit, përmes të cilave mundësohet prezantimi i opinionëve, komentëve dhe propozimeve. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit dhe funksionimit dhe natyrën e çështjeve për konsultim.

Ministritë respektivisht sipas fushave të cilat ato i kanë përgjegjësi, monitorojnë dhe kontrollojnë të gjitha veprimtaritë e organeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore, për zbatimin e të gjithë

normave dhe standarteve kombëtare të cilat janë të përcaktuara nga legjistacioni përkatës. Ministritë monitorojnë organet e pushtetit vendor edhe për funksionet e deleguara që kanë të drejtë t’i mbikëqyrin ato. Të gjitha vendimet, urdhërat dhe urdhëresat që kanë karakter normative të organeve të pushtetit vendor duhet që ti nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoritetet e përcaktuara me ligj.


Organet e pushtetit vendor duhet që në mënyrë të vazhdueshme t’i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe inspektimit financiar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit nëse janë duke i zbatuar normat dhe standartet kombëtare të përcaktuara në fushën e menaxhimit të financave publike sipas legjistacionit në fuqi.

Organet e pushtetit vendor i nënshtrohen kontrollit të jashtëm në lidhje me financat nga organet e pushtetit qendror për mënyrën se si janë përdorur fondet e kushtëzuara dhe fondet e deleguara të cilat financohen drejtëpërdrejtë nga Buxheti I Shtetit dhe nga fondet e ndihmës së huaj, të alokuara të njësitë e pushtetit vendor, sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga qeverisja vendore. Të gjitha organet e pushtetit vendore janë vazhdimishtë nën vëzhgimin dhe inspektim nga Kontrolli I Lartë I Shtetit sipas legjistacionit në fuqi.

2.8 Trendet dhe Zhvillimet e Decentralizimit Fiskal në Shqipëri

Indikatori i parë që pasqyron të ardhurat lokale në raport me PBB për çdo vende të BP individualisht dhe për BE si mesatare. Ky indikator është treguesi më domethënës i decentralizimit fiskal, sepse shpreh madhësinë e sektorit të qeverive lokale në raport me gjithë aktivitetin ekonomik të një vendi. Vendet e Ballkanit Perëndimor me mesataren prej 5.2% në raport me PBB janë në nivelin e 43% të mesatares së BE-së prej 12%. Grafikoni I mëposhtëm paraqet mesataren e treguesve kryesor fiskal për periudhën (2008-2018).

Grafiku 1 :Të ardhurat e qeverisë lokale si pjesë e PBB-së dhe të ardhurave totale publike (2008-2018)




Burimi: Treguesit e Decentralizimit Fiskal për Raportet e NALAS, kalkulim nga autori

Niveli i decentralizimit fiskal në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të merret me rezerve për arsye se organizimi teritorial i vendeve të BP është mjaftë asimetrik dhe se kompetencat e autoriteve lokale janë të ndryshme në vendet e ndryshme dhe për pasojë edhe niveli i financave lokale është në vëllim dhe cilësi mjaftë i ndryshëm.

Vlen të theksohet se nivelin më të ulët të decentralizimit fiskal lokal e ka Shqipëria me 3,1% të PBB-së ndërsa nivelin më të lartë të autonomisë lokale fiskale e ka Kosova me 6,72% të PBB-së që është për 29% më i lartë se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kuadër BiH, Shqipëria dhe Serbia kompetencat e arsimit parauniversitar dhe shëndetësis I kanë në nivel qendror dhe për pasojë të këtij fakti ulen në masë të konsiderueshme të hyrat dhe shpenzimet fiskale lokale. Gjatë viteve 2008-2018, qeveritë lokale në Shqipëri kanë marrë më pak të ardhura si pjesë të PBB-së dhe të ardhurave totale publike se të gjithë vendet tjera në Ballkanin Perëndimor. Kjo është për shkak të ndryshimit të shpeshtë të kompetencave lokale fiskale siç janë kufizimet mbi biznesin e vogël dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë të cilat kanë pasojë të pafavorshme në qeverisjen lokale.

Grafiku 2: Të ardhurat e qeverisë lokale dhe të ardhurat totale publike në Shqipëri




Burimi: Treguesit e financave të qeverisjes vendore në 2019 NALAS, Ministria e Financave Shqipëri

Indikatori i parë që analizojmë nga grafikoni i mësipërme është pjesa që zënë të ardhurat lokale në PBB e vendit. Ky indikator është treguesi më domethënës i decentralizimit fiskal, sepse shpreh madhësinë e sektorit të qeverive vendore në raport me gjithë aktivitetin ekonomik të një vendi.

Shqipëri shohim se për periudhën e analizës 11 vjeçare ka përbërjen e të ardhurave publike me mesatare prej 2.72%. Treguesi i dytë që paraqet grafikoni 3 është pjesa që zënë të ardhurat lokale publike në të ardhurat e konsoliduara publike të Qeverisë Qendrore. Ky tregues shpreh vendin që zë qeverisja vendore në strukturën e përgjithshme qeverisëse të një vendi.


Shqipëri shohim se për periudhën e analizës 11 vjeçare ka përbërjen e të ardhurave lokale publike në të ardhurat e konsoliduara publike të Qeverisë Qendrore me mesatare prej 10.63%.

Grafiku 3: Përbërja e të ardhurave le totali në përqindje në Shqipëri



Burimi: Treguesit e financave të qeverisjes vendore në 2019 NALAS, Ministria e Financave Shqipëri
 Përbërja e të ardhurave të qeverisjes lokale në Shqipëri ka qenë përafërsisht konstante për gjatë periudhës 2008 – 2018. Pjesa më e madhe e të hyrave siç prezentohet në grafikonin e mësipërm është realizuar nga të hyrat vetanake, gantet e përgjithshëm dhe granti i investimeve.


Grafiku 4: Përbërja e shpenzimeve lokale, totali në përqindje në Shqipëri



Burimi: Treguesit e financave të qeverisjes vendore në 2019 NALAS, Ministria e Financave Shqipëri

Përbërjen e shpenzimeve lokale e përbëjnë: Shpenzimet për paga dhe kompensimet e të punësuarëve në sektorin lokal të Shqipërisë marin pjesë me mesatare për 31.27% në nivelin e shpenzimeve të përgjithshme lokale me disa variacione gjatë periudhës së analizuar.

Grafiku 5: Investime nga niveli i qeverisë si % e PBB-së në Shqipëri



Burimi: Treguesit e financave të qeverisjes vendore në 2019 NALAS, Ministria e Financave Shqipëri

Shpenzimet për investime kapitale marrin pjesë mestarisht me 39.27 % pjesën tjetër e përbëjnë mallra dhe shërbime, grante dhe transfere të tjera.

2.9 Funkzionet e qeverisjes vendore

Detyrat e komunës janë të përcaktuara në Ligjin për Organizimin dhe Funkcionimin e Vendeve dhe Qeverisë, ku thuhet se juridiksioni i këshillit vendor shtrihet në të gjitha çështjet përveç nëse parashikohet ndryshe me legjislacion të veçantë. Komunat, bashkitë dhe qarqet kryejnë tre funksione:

- Funkzionet ekskluzive ose të mandatuara janë ato funksione që i jepen me ligj njësisë së qeverisjes vendore në momentin që mer mandatin e qeverisjes vendore, për realizimin e të cilave, është përgjegjëse dhe ka autoritetin që I duhet për të marrë vendime dhe për të përdorur mjetet për realizimin e tyre. Njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë veprimtari të plotë administrative, shërbimi, investimi dhe autoriteti rregullator mbi këto funksione.
- Funkzionet e përbashkëta janë funksione të cilat shoqërohen proporcionalisht me kompetenca dhe ushtrohen në mënyrë autonome realizohen në bashkëpunimin me qeverinë qendrore dhe njësia e qeverisjes vendore ka pjesën e saj të përgjegjësisë. (Hodaj, 2001)
- Funksione të deleguara janë ato funksione të pushtetit qendror ose të institucioneve të tjera qendrore por që me ligj ose me marrëveshje i kalohen për realizim njësisive të qeverisjes vendore. Realizimi i tyre nga njësitë e pushtetit vendor bëhet në mënyrën dhe masën e përcaktuar nga pushteti qendror dhe institucione të tjera qendrore.(Dobjani, 2007)

Komunat dhe bashkitë kanë këto funksione ekskluzive: furnizimi me ujë, sistemi i ujërave të zeza dhe kullimi dhe kanalet mbrojtëse në zonat e banuara, ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale, trotuareve dhe sheshit, ndriçimi publik, transport publik, varrezat dhe shërbimet funerale, dekorim qyteti/fshati, parqe dhe hapësira publike, menaxhimi i mbetjeve, planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe strehimi siç përshkruhet në ligj, lejet e ndërtimit, ruajtja dhe promovimi i vlerave kulturore dhe historike lokale, shërbimet sociale duke përfshirë jetimoret, kujdesin ditor, shtëpitë e të moshuarve, krijimi dhe menaxhimi i vendeve të tregut

publik, shërbime veterinarë, mbrojtja dhe zhvillimi i pyjeve dhe burimeve natyrore, zhvillimi i biznesit të vogël, mbrojtjen e rendit publik, siguria civile.

Komunat dhe bashkitë mund të ndërmarrin cilindo nga funksionet e përbashkëta të mëposhtme: arsimit parashkollor dhe parauniversitar, shërbimi shëndetësor prioritar dhe mbrojtja e shëndetit publik, ndihma sociale dhe zbutja e varfërisë dhe sigurimi i funksionimit të institucioneve ,rendit publik dhe mbrojtja civile, mbrojtja e mjedisit.(Hodaj, 2001)

3.0.Çfare është buxheti dhe rëndësia e tij

Një buxhet është shprehja sasiore e një plani për një periudhë të caktuar kohore. Mund të përfshijë vëllime dhe të ardhura të planifikuara të shitjeve, sasi të burimeve, kostot dhe shpenzimet, aktivet, detyrimet dhe flukset monetare. Prandaj, për të realizuar një plan-buxheti, ai duhet të përfshijë sasi të burimeve ekonomike që do të ndahen dhe përdoren, duhet të jetë e bërë për një periudhë të caktuar kohe, duhet të shprehet në terma monetarë, menaxherët duhet të veprojnë në një mënyrë që tregon synimin për të realizuar planin. Buxheti është një proces i të shprehurit sasior të kërkesave për burime (sasia e kapitalit, sasia e materialit, numri i njerëzve) në fazasynimet dhe pikat kryesore.(Schiavo-Campo, 2007)

Buxheti ndihmon në planifikimin e operacioneve aktuale duke i detyruar menaxherët të marrin në konsideratë se si kushtet mund të ndryshojnë dhe çfarë hapash duhet të ndërmerren tani dhe duke i inkurajuar menaxherët që të konsiderojnë problemet përpara se të shfaqen. Ai gjithashtu ndihmon në koordinimin e aktiviteteve të organizatës duke i detyruar menaxherët të shqyrtojnë marrëdhëniet ndërmjet operacioneve të tyre dhe atyre të departamenteve të tjerë.

Në përmbledhje, qëllimi i mjeteve të buxhetimit:

1. Mjetet ofrojnë një parashikim të të ardhurave dhe shpenzimeve, domethënë, ndërtojnë një model se si Bashkia mund të funksionojë financiarisht nëse zbatohen disa strategji, ngjarje dhe plane.
2. Mjetet mundësojnë matjen e funksionimit financiar aktual të Bashkisë kundrejt parashikim.
3. Së fundi, mjetet përcaktojnë kufizimin e kostos për një projekt, program ose operacion.

Buxheti i të hyrave përbëhet nga të ardhurat e qeverisë dhe shpenzimet e realizuara nga këto të ardhura. Të ardhurat tatimore përbëhen nga taksat dhe detyrimet e tjera që ka qeveria. Buxheti i shpenzimeve përfshin zërat e të dhënave të shpenzimeve (Gjika& Kokona& Mihali2012)

3.1.Struktura e Buxhetit Vendor

Struktura e buxhetit vendor përbëhet nga tre pjesë kryesore që janë: të ardhurat vetanake të bashkisë, transferta e pakushtëzuar dhe tranferta specifike.

- **Të Ardhurat Vetanake Të Bashkisë**

Tek të ardhurat vetanake të bashkisë përfshihen taksat, tatimet dhe tarifat. Tek taksat përfshihen taksat e biznesit të vogël, taksat mbi pronat e paluajtshme, taksat për akomodimin në hotel, tarifat e ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të reja, taksa e tokës bujqësore, taksa e kalimit të

së drejtës së pronësisë, taksa vjetore e regjistrimit të automjeteve, taksa për zënie e hapësirës publike, taksa për targa dhe taksa të tjera të përkohshme. Taksat kombëtare të përbashkëta si: tatimi mbi të ardhurat personale dhe taksat mbi fitimet e kompanive. Këto taksa do të mbledhen dhe shpërndahen nga qendra autoriteti.

Të ardhura të tjera jotatimore: të ardhura nga qiraja e tokës, shitja e aseteve kapitale të njësisë vendore, të ardhurat nga grantet, sponsorizimet ose kundërvajtjet administrative gjopa, tarifa për çerdhe, kopshte, studentë me bursë etj.

Tarifat për shërbimet publike të kryera nga NJQV-të si pastrimi, ndriçimi publik, dhënia e licencave për ushtrimin e veprimtarisë private, reklamat etj.

- **Transferta E Pakushtëzuar**

Transfertat nga pushteti qendror: fondet e pakushtëzuara janë ato që NJQV-të marrin për përmbushjen e funksioneve të tyre dhe të përbashkëta pa kusht kthimi. Transfertat vertikale të kompensimit, të cilat bazohen në ndarjen e përgjegjësive dhe funksioneve ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore që synojnë mbështetjen në përgjithësi të shpenzimeve të funksioneve të NJQV-ve dhe shërbimeve publike. Grantet e barazimit ose transfertat e kompensimit horizontal që synojnë mbështetjen QL që objektivist u mungojnë të ardhurat dhe burimet kombëtare.

- **Tranferta Specifike**

Tek transfertat specifike përfshihen grantet me kusht konkurruese për të kryer funksionet dhe kompetencat e deleguara, parashikohen të përdoren për qëllimin e caktuar dhe në fund, nëse nuk përdoren të kthehet në Buxhetin e Shtetit dhe kjo shumë miratohet gjatë vitit financiar e në vazhdim, pjesë përbërëse të buxhetit janë kredia dhe kostot e njësive të qeverisjes vendore.

- **Kredia**

Kredia që nga viti 2008 mund të merret nga institucionet financiare vendase, bankat ose Qeveria qendrore. Kredia nuk mund të kalojë 130% të transfertes se pakushtëzuara dhe jo më shumë se 20% të transferimit të kushtëzuar për tre vjet dhe në të paktën 71% e suficitit operativ të

NJQV-ve të tejkalojnë kredinë. Merret me financimin mungesa e përkohshme në para, investime ose deficit afatshkurtër.(Dragusha & Osmani, 2012)

- **Kostot e njësive të qeverisjes vendore**

Shpenzimet për funksionet e tij (ekskluzive): të cilat financohen nga burimet e veta dhe transferta të pakushtëzuara nga buxheti i shtetit dhe parashikohet në fillim në fazat e hartimit të buxhetit. Kjo kategori përfshin kostot për administrim si paga, kontribute, shpenzime dhe investime. Kostot për funksionet e përbashkëta: nga transfertat e pakushtëzuara nga buxheti i shtetit për NJQV-të, të ardhurat e saj për NJQV-të, grantet konkurruese për edukimin, për investime, kujdesin parësor shëndetësor, mbrojtjen e shëndetit publik. Kostot për funksionet e deleguara: Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për QKR (Qendra Kombëtare e Regjistrimit) dhe gjendjes civile, ndihma ekonomike e financuar nga transfertat e kushtëzuara..

3.1. Analiza financiare e buxhetit të Bashkisë Dibrë për vitin 2016

Projekcionet dhe realizimet e të ardhurave dhe Shpenzimeve buxhetore

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura evidenca e të ardhurave dhe evidence e shpenzimeve për vitin 2016.

Tabela nr.1: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2016

Evidenca e të ardhurave						
2016						
Nr.	Pershkrimi	Plan (lek)	Plan (euro)	Fakt (lek)	Fakt (euro)	Realizimi ne %
1	Te ardhura nga granti	596,125,324.00	4,926,655.57	596,125,324.00	4,926,655.57	100.00
2	Te ardhura nga taksat	46,098,000.00	380,975.21	24,057,771.00	198,824.55	52.19
3	Te ardhura nga tatimet	20,187,000.00	166,834.71	13,580,789.00	112,237.93	67.27
4	Te ardhura nga tarifaf	47,240,000.00	390,413.22	20,024,303.00	165,490.11	42.39
5	Te ardhura te tjera	23,080,000.00	190,743.80	20,462,463.00	169,111.26	88.66
6	Grant nga nivele te tjera qeverisje	-	-	378,100.00	3,124.79	
7	Fonde te deleguara	1,442,914,607.00	11,924,914.11	1,370,020,595.00	11,322,484.26	94.95
	Gjithsej te ardhura	2,175,644,931.00	17,980,536.62	2,044,649,345.00	16,897,928.47	93.98
Evidenca e shpenzimeve						
2016						
Nr.	Pershkrimi	Plan (lek)	Plan (euro)	Fakt (lek)	Fakt (euro)	Realizimi ne %
1	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patruazuara	9,640,697.00	79,675.18	1,173,000.00	9,694.21	12.17
2	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te truazuara	579,763,549.00	4,791,434.29	284,511,556.00	2,351,335.17	49.07
3	Kreditore per mjete ne ruajtje	-	-	5,869,000.00	48,504.13	
4	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	302,477,817.00	2,499,816.67	289,167,228.00	2,389,811.80	95.60
5	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	50,737,108.00	419,314.94	46,955,224.00	388,059.70	92.55
6	Mallra dhe shpenzime te tjera	145,809,190.00	1,205,034.63	105,430,921.00	871,329.93	72.31
7	Transferime korrente te brendshme	8,657,354.00	71,548.38	7,065,169.00	58,389.83	81.61
8	Transferita per buxhet familjare dhe individe	800,336,744.00	6,614,353.26	766,201,000.00	6,332,239.67	95.73
9	446 5%(garanci punimesh)			1,682,722.00	13,906.79	
10	604 mbart(transferime te brendshme per individe)			889,670.00	7,352.64	
11	Shpenzime nga institucionet ne nenvaresi te bashkise	278,222,472.00	2,299,359.27	24,360,002.00	201,322.33	8.76
	Gjithsej shpenzime	2,175,644,931.00	17,980,536.62	1,533,305,492.00	12,671,946.21	70.48

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Tek evidenca e të ardhurave janë paraqitur të ardhurat vetanake të Bashkisë Dibrë dhe të ardhurat nga granti dhe në total këto të ardhura kapin vlerën e 2,044,649,345 lek . Në bazë të të dhënave për planin e të ardhurave dhe faktin se sa janë realizuar këto të ardhura është llogaritur përqindja e realizimit për secilën të ardhur në vecanti dhe përqindja e realizimit për të gjithë të ardhurat në total. Nga këto vërejmë se granti ka realizim 100 % sepse aq sa planifikohet vlera e grantit qeveritar në atë vlerë vjen nga qeveria, ndërsa përqindjen më të vogël të realizimit e kanë të ardhurat nga taksat. Nga kjo analizë konstatohet se për vitin 2016 kemi një realizim të ardhurash me 93.98%, vlerë në të cilën peshën më të madhe e mbajnë të ardhurat nga grantet dhe fondet qeveritare ndërsa për sa u përket të ardhurave vetanake kemi një realizim të ulët.

Në evidencën e shpenzimeve evidentohet se shpenzimet e realizuara për vitin 2016 kapin vlerën e 1,533,305,492 lek nga 2,175,644,931 lek që ishin planifikuar për tu shpenzuar, domethënë që realizimin e shpenzimeve e kemi me 70.48%.

Nga këto shpenzime kemi një realizim më të ulët tek shpenzimet e realizuara nga institucionet që janë nënvarësinë e Bashkisë Dibrë me 8.76%, arsyeja e kësaj përqindje të ulët është mosrealizimi I disa shpenzimeve operative që janë planifikuar por nuk janë realizuar. Ndërsa përqindjen më të lartë të realizimit të shpenzimeve e kemi për transfertat për buxhet familjare dhe individë të paguara nga Instituti Sigurimeve Shoqërore, Instituti I sigurimit te Kujdesit Shëndetësor dhe Pushteti Vendor ku bëjnë pjesë kompesime paafëtish dhe pagesa te parakohshme, këto shpenzime janë realizuar 95.75%.


Të ardhurat e Bashkisë Dibrë për vitin 2016 kanë vlerën 2,044,649,345.00 lek dhe nga këto të ardhura 596,503,424 lek pra 29.17% janë të ardhura nga granti, 78,125,326 lek pra 3.82% janë të ardhurat vetanake të bashkisë dhe pjesa tjetër 1,370,398,695 lek pra 67.01% janë të ardhura te realizuara nga fondet e deleguara.

Tabela nr.2: Realizimet e të ardhurave për vitin 2016

Viti 2016	Lek	Euro	%
Te ardhura te realizuara nga granti	596,503,424.00	4,929,780.36	29.17
Te ardhurat vetanake te realizuara	78,125,326.00	645,663.85	3.82
Te ardhurat e realizuara nga fondet	1,370,398,695.00	11,325,609.05	67.01
Gjithsej te ardhura	2,045,027,445.00	16,901,053.26	

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Grafiku 6: Të ardhurat e realizuara për vitin 2016



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës
Nga paraqitja grafike e të ardhurave duket qartë diferenca në vlerë e të ardhurave nga granti me të ardhurat vetanake te bashkisë.


Shpenzimet e bashkise Diber per vitin 2016 arrijne vleren 1,533,305,492.00 lek nga te cilat kemi 1,487,013,107.00 lek shpenzime te realizuara nga granti dhe 46,292,385.00 lek shpenzime te realizuara nga te ardhurat vetanake. Pra kemi 96.98% te shpenzimeve te realizuara nga granti dhe 3.02% te shpenzimeve te realizuara nga te ardhurat vetanake te Bashkise Diber.

Tabela nr.3: Realizimet e të shpenzimeve për vitin 2016

	2016	Euro	%
Shpenzime te realizuara nga granti	1,487,013,107.00	12,289,364.52	96.98
Shpenzime te realizuara nga te ardhurat e bashkise	46,292,385.00	382,581.69	3.02
Gjithsej shpenzime	1,533,305,492.00	12,671,946.21	

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Grafiku 7: Shpenzimet e realizuara për vitin 2016



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Nga paraqitja grafike e shpenzimeve shohim se pjesa më e madhe e shpenzimeve janë të realizuara nga granti dhe një pjesë e vogël e tyre është e realizuar nga te ardhurat vetanake të bashkisë.

3.1. Analiza financiare e buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2017

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur evidencat etë ardhurave dhe evidencat e shpenzimeve për vitin 2017.

Tabela nr.4: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2017

Evidenca e të ardhurave						
2017						
Nr.	Pershkrimi	Plan (lek)	Plan (euro)	Fakt (lek)	Fakt (euro)	Realizimi ne %
1	Te ardhura nga granti	766,200,379	6,332,234.54	766,200,379	6,332,234.54	100.00
2	Te ardhura nga taksat	39,955,000.00	330,206.61	22,593,328.00	186,721.72	56.55
3	Te ardhura nga tatimet	14,370,000.00	118,760.33	9,895,066.00	81,777.40	68.86
4	Te ardhura nga tarifat	48,834,000.00	403,586.78	41,648,899.00	344,205.78	85.29
5	Te ardhura te tjera	6,568,000.00	54,280.99	7,382,538.00	61,012.71	112.40
6	Grant nga nivele te tjera qeverisje	512,596,603.00	4,236,335.56	512,596,603.00	4,236,335.56	100.00
7	Fonde te deleguara	1,020,272,006.00	8,432,000.05	971,818,557.00	8,031,558.32	95.25
	Gjithsej te ardhura	2,408,795,988.00	19,907,404.86	2,332,135,370.00	19,273,846.03	96.62
Evidenca e shpenzimeve						
2017						
Nr.	Pershkrimi	Plan (lek)	Plan (euro)	Fakt (lek)	Fakt (euro)	Realizimi ne %
1	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	21,473,117.00	177,463.78	9,242,423.00	76,383.66	43.04
2	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	488,016,944.00	4,033,197.88	326,689,865.00	2,699,916.24	66.94
3	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	452,677,833.00	3,741,139.12	391,715,988.00	3,237,322.21	86.53
4	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	79,726,848.00	658,899.57	62,484,686.00	516,402.36	78.37
5	Mallra dhe shpenzime te tjera	181,958,096.00	1,503,785.92	152,692,990.00	1,261,925.54	83.92
6	Transferime korrente te brendshme	33,369,704.00	275,782.68	20,764,429.00	171,606.85	62.23
7	Transferata per buxhet familjare dhe individe	853,330,855.00	7,052,321.12	840,112,528.00	6,943,078.74	98.45
8		4665110	-	5,269,976.00	43,553.52	
9		4662114	-	10,402,235.00	85,968.88	
10		4662104	-	15,070,379.00	124,548.59	
11	Shpenzime nga institucionet ne nenvaresi te bashkise	298,242,591.00	2,464,814.80	280,341,692.00	2,316,873.49	94.00
	Gjithsej shpenzime	2,408,795,988.00	19,907,404.86	2,114,787,191.00	17,477,580.09	87.79

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Nga të dhënat e mësipërme të paraqitura në tabelë kemi që të ardhurat gjithsej për vitin 2017 janë në vlerën 2,332,135,370 lek, nga ku kemi grantin që kap vlerën 766,200,379 lek, kemi të ardhurat vetanake të bashkisë që kapin vlerën 84,519,831 lek. Të ardhurat e grantit nga nivele të tjera të qeverisjes arrijnë në vlerën 512,596,603 lek, ndërsa nga fondet e deleguara të ardhura janë në vlerën 971,818,557 lek për vitin 2017. Nga tabela konstatohet që të ardhura në total janë realizuar 96.63 %, ku përqindjen më të ulët të realizimit e kanë të ardhurat nga taksat.

Për sa u përket shpenzimeve për vitin 2017 vërejmë që shpenzimet e realizuara kapin vlerën 2,114,787,191 lek nga 2,408,795,988lek që ishin planifikuar për tu shpenzuar. Nga dhenat e perlllogaritura kemi që shpenzimet janërealizur me 87.79% , nga ku përqindjen më të vogël të realizimit e kemi tek shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupezuara ku përfshihen shpenzime dhe prime te emisionit ose rimbursimit te huave,shpenzime per studime ose kerkime,koncesione , patenta, licenca, marka, te drejta e tjera me 43.04%, ndëra përqindjen

më të lartë te realizimit te shpenzimeve e kemi tek transfertat për buxhet familjar dhe individë me 98.45%.


Nga tabela e mëposhtme vërejmë që të ardhurat nga granti arrijnë vlerën 766,200,379 lek pra janë 32.85% e totalit të të ardhurave, të ardhurat vetanake të bashkisë arrijnë në vlerën 81,519,831 lek pra janë 3.50% e totalit te te ardhurave, ndërsa për sa u përket te ardhura te realizuar nga fondet e deleguara arrijne vlerën 1,484,415,160 lek dhe janë 63.65% e të gjithë të ardhurave. Të ardhurat nga granti dhe nga fondet e deleguara zënë 96.50% të totalit kundrejt të ardhurave vetanake të bashkisë që zënë vetëm 3.50% të totalit.

Tabela nr.5: Realizimet e të ardhurave për vitin 2017

Viti 2017	Lek	Euro	%
Te ardhura te realizuara nga granti	766,200,379.00	6,332,234.54	32.85
Te ardhurat vetanake te realizuara	81,519,831.00	673,717.61	3.50
Te ardhurat e realizuara nga fondet	1,484,415,160.00	12,267,893.88	63.65047
Gjithsej te ardhura	2,332,135,370.00	19,273,846.03	

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Grafiku 8: Të ardhurat e realizuara për vitin 2017



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Për vitin shpenzimet në total kanë vlerën 17,477,580 euro. Nga totali I shpenzimeve kemi që 96.15% të shpenzimeve janë realizuar nga te ardhurat e grantit që e përthyer në vlerë është


2,033,267,360 lek dhe 3.85% e shpenzimeve është e realizuar nga të ardhurat vetanake të bashkisë që e përkthyer në vlerështë 81,519,831 lek.

Tabela nr.6: Realizimet e të shpenzimeve për vitin 2017

2017	Lek	Euro	%
Shpenzime te realizuara nga granti	2,033,267,360.00	16,803,862.48	96.15
Shpenzime te realizuara nga te ardhurat e bashkise	81,519,831.00	673,717.61	3.85
Gjithsej shpenzime	2,114,787,191.00	17,477,580.09	

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Grafiku 9: Shpenzimet e realizuara për vitin 2017



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

3.1. Analiza financiare e buxhetit të Bashkisë Dibrë për vitin 2018

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur evidencat e të ardhurave dhe evidencat e shpenzimeve për vitin 2018.

Tabela nr.7: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2018

Evidenca e të ardhurave						
2018						
Nr.	Pershkrimi	Plan (lek)	Plan (euro)	Fakt (lek)	Fakt (euro)	Realizimi ne %
1	Te ardhura nga granti	648,352,453.00	5,358,284.74	648,352,453.00	5,358,284.74	100.00
2	Te ardhura nga taksat	49,456,000.00	408,727.27	32,962,790.00	272,419.75	66.65
3	Te ardhura nga tatimet	27,128,000.00	224,198.35	10,661,596.00	88,112.36	39.30
4	Te ardhura nga tarifrat	57,343,000.00	473,909.09	23,780,512.00	196,533.16	41.47
5	Te ardhura te tjera	8,414,000.00	69,537.19	8,325,129.00	68,802.72	98.94
6	Grant nga nivele te tjera qeverisje	-	-	1,400,000.00	11,570.25	
7	Fonde te deleguara	902,743,270.00	7,460,688.18	901,327,409.00	7,448,986.85	99.84
	Gjithsej te ardhura	1,693,436,723.00	8,637,060.08	1,626,809,889.00	13,444,709.83	96.07
Evidenca e shpenzimeve						
2018						
Nr.	Pershkrimi	Plan (lek)	Plan (euro)	Fakt (lek)	Fakt (euro)	Realizimi ne %
1	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	3,995,714.00	33,022.43	3,995,714.00	33,022.43	100.00
2	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	267,669,298.00	2,212,142.96	244,085,510.00	2,017,235.62	91.19
3	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	381,580,869.00	3,153,560.90	372,486,454.00	3,078,400.45	97.62
4	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	60,537,534.00	500,310.20	58,995,938.00	487,569.74	97.45
5	Mallra dhe shpenzime te tjera	95,489,346.00	789,168.15	90,722,476.00	749,772.53	95.01
6	Transferime korrente te brendshme	8,077,724.00	66,758.05	7,380,272.00	60,993.98	91.37
7	Transferata per buxhet familjare dhe individe	770,113,646.00	6,364,575.59	765,379,161.00	6,325,447.61	99.39
8		4665110	-	3,552,000.00	29,355.37	
9		4662114	-	2,452,831.00	20,271.33	
10		4662104	-	12,405,625.00	102,525.83	
11	Shpenzime nga institucionet ne nenvaresi te bashkise	105,972,592.00	875,806.55	60,845,670.00	502,856.78	57.42
	Gjithsej shpenzime	1,693,436,723.00	13,995,344.82	1,622,301,651.00	13,407,451.66	95.80

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Nga evidenca e të ardhurave konstatojmë se të ardhurat për vitin 2018 janë planifikuar 1,693,436,723 lek dhe janë realizuar 1,626,809,889 lek domethënë që kemi një realizim të të ardhurave me 96.07%. Nga këto të ardhura kemi 1,551,079,862 lek që janë të ardhura nga grantet dhe nga fondet e deleguara. Ndërsa të ardhurat vetanake të bashkisë kanë një realizim prej 75,730,027 lekësh. Tek të ardhurat e vitit 2018 kemi një realizim me 96.07% ku përqindjen më të madhe të realizimit e kemi nga grantet dhe nga fondet e deleguara me 100% dhe 99.84%, ndërsa përqindjen më të ulët të realizimit e kemi tek të ardhurat nga tatimet me 39.30%.

Nga evidence e shpenzimeve për vitin 2018 vërejmë që shpenzimet për këtë vit janë planifikuar në vlerën 1,693,436,723 lek dhe janë realizuar në vlerën 1,622,301,651 lek, pra kemi një realizim me 95.80%. Përqindjen më të lartë të realizimit të shpenzimeve e kemi tek shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara, që kanë një realizim prej 100%, ndërsa

përqindjen më të ulët të realizimit të shpenzimeve e kemi tek shpenzimet nga institucionet në nënvarësinë e bashkisë Dibrë me 57.42%


Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të ardhurat e bashkisë duke specifikuar burimet e të ardhurave. Nga tabela konstatojmë se për vitin 2018 kemi 648,352,453 lek të ardhura nga granti që e përkthyer në përqindje është 39.85%, 75.730.027 lek të ardhura vetanake të realizuar nga bashkia dhe 902,727,409 lek janë të ardhurat e realizuara nga fondet e deleguara.

Tabela nr.8: Realizimet e të ardhurave për vitin 2018

2018	Lek	Euro	%
Te ardhura te realizuara nga granti	648,352,453.00	5,358,284.74	39.85
Te ardhurat vetanake te realizuara	75,730,027.00	625,867.99	4.66
Te ardhurat e realizuara nga fondet	902,727,409.00	7,460,557.10	55.49
Gjithsej te ardhura	1,626,809,889.00	13,444,709.83	

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Grafiku 10: Të ardhurat e realizuara për vitin 2018



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Për vitin 2018 kemi që 95.47% e shpenzimeve janë realizuar nga granti dhe nga fondet e deleguara pra ne vlerën 1,548,825,743 lek. Ndërsa për sa u përket shpenzimeve te realizuara nga të ardhurat bashkiake kemi që vetëm 4.53% e shpezmeve janë realizuar nga këto të ardhura pra 73,475,908 lek.


Tabela nr.9: Realizimet e të shpenzimeve për vitin 2018

2018	Lek	Euro	%
Shpenzime te realizuara nga granti dhe fondet	1,548,825,743.00	12,800,212.75	95.47
Shpenzime te realizuara nga te ardhurat e bashkise	73,475,908.00	607,238.91	4.53
Gjithsej shpenzime	1,622,301,651.00	13,407,451.66	

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Nga paraqitja grafike duket qartë që edhe për vitin 2018 shpenzimet e realizuara nga të ardhurat nga granti dhe nga fondet jane shumë më të mëdhaja sesa shpenzimet e realizuara nga të ardhurat vetanake të bashkisëDibër .

Grafiku 11: Shpenzimet e realizuara për vitin 2018



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

3.4 Analiza financiare e buxhetit të Bashkise Diber për vitin 2019

Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur evidencën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019.

Tabela nr.10: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019

Evidenca e të ardhurave						
2019						
Nr.	Pershkrimi	Plan (lek)	Plan (euro)	Fakt (lek)	Fakt (euro)	Realizimi ne %
1	Te ardhura nga granti	665,123,136.00	5,496,885.42	665,123,136.00	5,496,885.42	100.00
2	Te ardhura nga taksat	53,155,000.00	439,297.52	38,382,500.00	317,210.74	72.21
3	Te ardhura nga tatimet	26,731,000.00	220,917.36	13,417,668.00	110,889.82	50.20
4	Te ardhura nga tarifrat	56,901,000.00	470,256.20	54,417,080.00	449,727.93	95.63
5	Te ardhura te tjera	8,400,000.00	69,421.49	8,385,325.00	69,300.21	99.83
6	Grant nga nivele te tjera qeverisje		-	4,198,405.00	34,697.56	
7	Fonde te deleguara	869,968,902.00	7,189,825.64	868,415,449.00	7,176,987.18	99.82
	Gjithsej te ardhura	1,680,279,038.00	13,886,603.62	1,652,339,563.00	13,655,698.87	98.34
Evidenca e shpenzimeve						
2019						
Nr.	Pershkrimi	Plan (lek)	Plan (euro)	Fakt (lek)	Fakt (euro)	Realizimi ne %
1	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	857,143.00	7,083.83	857,143.00	7,083.83	100.00
2	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	144,802,826.00	1,196,717.57	129,748,004.00	1,072,297.55	89.60
3	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	428,194,518.00	3,538,797.67	407,176,060.00	3,365,091.40	95.09
4	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	70,426,385.00	582,036.24	68,654,272.00	567,390.68	97.48
5	Mallra dhe shpenzime te tjera	146,063,556.00	1,207,136.83	136,578,970.00	1,128,751.82	93.51
6	Transferime korrente te brendshme	8,496,193.00	70,216.47	5,755,574.00	47,566.73	67.74
7	Transferata per buxhet familjare dhe individe	778,882,366.00	6,437,044.35	777,221,017.00	6,423,314.19	99.79
8		4665110	-	3,166,454.00	26,169.04	
9		4662114	-	6,536,230.00	54,018.43	
10		4662104	-	14,904,813.00	123,180.27	
11	Shpenzime nga institucionet ne nenvaresi te bashkise	102,556,051.00	847,570.67	90,045,310.00	744,176.12	87.80
	Gjithsej shpenzime	1,680,279,038.00	13,886,603.62	1,640,643,847.00	13,559,040.06	97.64

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Nga paraqitja tabelare e të ardhurave dhe shpenzimeve vërejmë që për vitin 2019 kemi që planifikimi I të ardhura arrin në vlerën 1,680,279,038 lek , ndërsa realizimi I të ardhurave kap vlerën 1,652,339,563 lek pra kemi një realizim të të ardhurave me 98.34%. Nga përllogarritja e realizimit të të ardhurave kemi që përqindjen më të ulët tek të ardhurat nga tatimet me 50.02% , ndërsa për sa I përket të ardhurave që kanë përqindjen më të lartë janë të ardhurat nga granti që

janë realizuar 100% duke qenë se granti aq sa parashikohet në buxhet në atë vlerë vjen nga qeveria.

Nga evidenca e shpenzimeve konstatohet se për vitin 2019 janë parashikuar për tu shpenzuar 1,680,279,038 lek dhe janë shpenzuar 1,640,643,847 lek, pra kemi një realizim të shpenzimeve me 97.64% . Nga këto shpenzime kemi përqindjen më të ulët të realizimit tek transferime korrente të brendshme ku përfshihen Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë, Institucione Qeveritare të Ndryshme, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësor, organizatat jo-fitimprurëse, këto shpenzime janë realizuar 67.74%. Ndërsa për sa u përket shpenzimeve që kanë përqindjen më të lartë të realizimit kemi shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara që janë realizuar me 100%.


Nga tabela e mëposhtme konstatohet se për vitin 2019 kemi që të ardhurat e realizuara nga granti kanë vlerën 665,123,136 lek pra 40.25% e të ardhurave totale, të ardhurat vetanake që ka realizuar bashkia janë në vlerën 114.602.573 lek pra 6.94% e të ardhurave totale. Ndërsa për sa u përket të ardhurave të realizuara nga fondet që vijnë nga qeveria gjithashtu ato kapin vlerën 872,613,854 lek pra 52.81% të të ardhurave totale. Gjithsej të ardhurat për vitin 2019 kanë vlerën 1,652,339,563 lek që e konvertuar në euro është 13.655.698.87 euro.

Tabela nr.11: Realizimet e të ardhurave për vitin 2019

2019	Lek	Euro	%
Te ardhura te realizuara nga granti	665,123,136.00	5,496,885.42	40.25
Te ardhurat vetanake te realizuara	114,602,573.00	947,128.70	6.94
Te ardhurat e realizuara nga fondet	872,613,854.00	7,211,684.74	52.81
Gjithsej te ardhura	1,652,339,563.00	13,655,698.87	

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Grafiku 12: Të ardhurat e realizuara për vitin 2019



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës


Për vitin 2019 shpenzimet e realizuara nga bashkia Dibrë kanë vlerën 1,640,643,847 lek nga keto shpenzime 1,531,889,132 lek janë shpenzime të realizuara nga te ardhurat e grantit dhe fondeve të deleguara, pra 93.37% nga totali. Ndërsa për sa u përket shpenzimeve të realizuara nga te ardhurat vetanake te bashkisë ato kanë vlerën 108,754,715 lek, pra 6.63% e të gjithë totalit. Gjithsej shpenzimet e bashkisë të realizuar për vitin 2019 janë 13,559,040 euro.

Tabela nr.12: Realizimet e të shpenzimeve për vitin 2019

2019	Lek	Euro	%
Shpenzime te realizuara nga granti dhe fondet	1,531,889,132.00	12,660,240.76	93.37
Shpenzime te realizuara nga te ardhurat e bashkise	108,754,715.00	898,799.30	6.63
Gjithsej shpenzime	1,640,643,847.00	13,559,040.06	

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Grafiku 13: Shpenzimet e realizuara për vitin 2019



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

3.4 Analiza financiare e buxhetit te Bashkise Diber per vitin 2020

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur evidence e të ardhurave dhe evidenca e shpenzimeve për vitin 2020.

Tabela nr.13: Projektionet dhe realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2020

“Analiza e nivelit të decentralizimit fiskal në Republikën e Shqipërisë, rast studimor bashkia e Dibrës”

Evidenca e të ardhurave						
2020						
Nr.	Pershkrimi	Plan (lek)	Plan (euro)	Fakt (lek)	Fakt (euro)	Realizimi ne %
1	Te ardhura nga granti	689,130,901.00	5,695,296.70	689,130,901.00	5,695,296.70	100.00
2	Te ardhura nga taksat	39,676,000.00	327,900.83	42,695,938.00	352,858.99	107.61
3	Te ardhura nga tatimet	22,155,000.00	183,099.17	22,280,886.00	184,139.55	100.57
4	Te ardhura nga tarifatat	75,530,000.00	624,214.88	35,843,370.00	296,226.20	47.46
5	Te ardhura te tjera	10,730,000.00	88,677.69	12,123,246.00	100,192.12	112.98
6	Grant nga nivele te tjera qeverisje			4,926,036.00	40,711.04	
7	Fonde te deleguara	1,307,184,687.00	10,803,179.23	1,221,434,447.00	10,094,499.56	93.44
	Gjithsej te ardhura	2,144,406,588.00	17,722,368.50	2,028,434,824.00	16,763,924.17	94.59
Evidenca e shpenzimeve						
2020						
Nr.	Pershkrimi	Plan (lek)	Plan (euro)	Fakt (lek)	Fakt (euro)	Realizimi ne %
1	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	7,972,673.00	65,889.86	6,907,639.00	57,087.93	86.64
2	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	448,059,126.00	3,702,967.98	395,379,722.00	3,267,601.01	88.24
3	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	400,216,027.00	3,307,570.47	381,722,282.00	3,154,729.60	95.38
4	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	69,395,210.00	573,514.13	66,286,138.00	547,819.32	95.52
5	Mallra dhe shpenzime te tjera	153,173,128.00	1,265,893.62	13,069,186.00	108,009.80	8.53
6	Transferime korrente te brendshme	17,129,330.00	141,564.71	6,413,104.00	53,000.86	37.44
7	Transferta per buxhet familjare dhe individe	969,998,996.00	8,016,520.63	965,511,573.00	7,979,434.49	99.54
8		4665110		2,514,150.00	20,778.10	
9		4662114		4,792,686.00	39,608.98	
10		4662104		9,877,954.00	81,635.98	
11	Shpenzime nga institucionet ne nenvaresi te bashkise	78,462,098.00	648,447.09	25,512,600.00	210,847.93	32.52
	Gjithsej shpenzime	2,065,944,490.00	17,073,921.40	1,877,987,034.00	15,520,554.00	90.90

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Për vitin 2020 të ardhurat janë planifikuar në vlerën 2,144,406,588 lek dhe janë realizuar 2,028,434,824 lek pra kemi një realizim të të ardhurave me 94.59%. Përqindjen më të lartë të realizimit të të ardhurave për vitin 2020 e kemi tek të ardhurat e tjera me 112.98% pra janë planifikuar për tu realizuar 10,730,000 lek dhe janë realizuar 12,123,246 lek. Tek të ardhurat e tjera përfshihen: të ardhurat nga qera trualli, nga qeratat për ndërtesat, nga kopshtet dhe cerdhet, të ardhurat sekondare, shitje shtypshkrime, gjoba, të ardhura të tjera jo tatimore, të nga shërbimi MNZ, të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia, të ardhura nga biletat e qendrës kulturore, të ardhura nga biletat e muzeut, të ardhura nga qeratat për toka bujqësore, nga kullotat, hidrocentralet, minierat, rentat minerare, të ardhura nga antenat telefonike dhe televizive, të ardhura vendore për shfrytësimin e lëndës drusore dhe kamatvonesat. Përqindjen më të ulët të realizimit të të ardhurave e kemi tek të ardhurat nga tarifatat me 47.46% pra është planifikuar që nga tarifatat të mbledhen 75,530,000 lek dhe në fakt janë mbledhur vetëm 35,843,370 lek për vitin 2020.

Për vitin 2020 janë planifikuar që të shpenzohen 2,065,944,490 lek dhe janë shpenzuar 1,877,987,034 lek pra janë shpenzuar 90.90% nga vlera që është planifikuar për tu shpenzuar. Shpenzimet për mallra për vitin 2020 kanë përgjindjen më të ulët të realizimit me 8.53% pra nga 153,173,128 lek që ishin planifikuar për tu shpenzuar janë shpenzuar vetëm 13,069,186 lek. Ndërsa përqindjen më të lartë të realizimit të shpenzimeve e kemi tek transfertat

për buxhet familjarë dhe individë me 99.54% , pra janë planifikuar për tu shpenzuar 969,998,996 lek dhe janë shpenzuar 965,551,573 lek . Në total shpenzimet e realizuara kanë vlerën 15,520,554 euro.


Nga tabela e mëposhme vërejmë që të ardhurat e realizuar për vitin 2020 në bashkinë Dibër kanë vlerën 2,028,434,824 lek .Nga të cilat kemi 689,130,901 lek që janë të ardhura të realizuar nga granti pra 33.97% e të ardhurave vijnë nga granti qeveritar. Të ardhurat vetanake të realizuara nga bashkia janë 112,943,440 lek pra 5.57% e të ardhurave në total vijnë nga mbledhja e taksave, tatimeve, tarifave dhe të ardhurave të tjera vetanake të bashkise. Pastaj kemi të ardhurat e realizuara nga fondet që kanë vlerën 1,226,360,483 lek pra kanë 60.46% e totalit një përqindje më e lartë në krahasim me të ardhurat vetanake dhe të ardhurave nga granti . Në total kemi 16,763,924 euro të akumuluar për vitin 2020.

Tabela nr.14: Realizimet e të ardhurave për vitin 2020

Viti 2020	Lek	Euro	%
Te ardhura te realizuara nga granti	689,130,901.00	5,695,296.70	33.97
Te ardhurat vetanake te realizuara	112,943,440.00	933,416.86	5.57
Te ardhurat e realizuara nga fondet	1,226,360,483.00	10,135,210.60	60.46
Gjithsej te ardhura	2,028,434,824.00	16,763,924.17	

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Grafiku 14: Të ardhurat e realizuara për vitin 2020



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës


Shpenzimet e realizuara nga bashkia Dibër për vitin 2020 kanë vlerën 1,899,987,034 lek nga të cilat 1,840,267,489 lek janë shpenzime të realizuara nga të ardhurat e grantit qeveritar pra 97.99%. Ndërsa shpenzimet e realizuara nga të ardhurat vetanake të bashkisë Diber kanë vlerën 37,719,545 lek pra 2.01% e totalit të shpenzimeve.

Tabela nr.15: Realizimet e të shpenzimeve për vitin 2020

2020	Lek	Euro	%
Shpenzime të realizuara nga granti	1,840,267,489.00	15,208,822.22	97.99
Shpenzime të realizuara nga të ardhurat e bashkisë	37,719,545.00	311,731.78	2.01
Gjithsej shpenzime	1,877,987,034.00	15,520,554.00	

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Grafiku 15: Shpenzimet e realizuara për vitin 2020



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës


3.6 Krahasimi I buxheteve të Bashkisë për periudhën kohore 2016-2020

Të ardhurat e realizuara nga granti për vitet 2016-2020

Granti është shuma e përcaktuar e fondit për mbështetjen e shoqërisë civile, e shpallur në dokumentet e konkurrimit, gjatë një procedure konkrete, që i dhurohet pa interes subjektivit përfitues nga autoriteti përfitues, në përputhje me kriteret e vendosura sipas këtij ligji.

Grafiku I mëposhtëm paraqet analizen e të ardhurave nga granti për vitet 2016-2020. Në këtë analizë është përfshirë planifikimi i grantit dhe realizimi i tij për këto 5 vite. Vlera e grantit të planifikuar dhe e grantit të realizuar është e barabartë me vlerën e realizuar të grantit kjo për arsye se granti aq sa planifikohet në buxhet në atë vlerë vjen nga qeveria. Përgjatë viteve 2016-2020 kemi një tendencë kryesive në rritje me përjashtim të vitit 2018 ku granti ka pasur një rënie.

Grafiku 16: Projektionet dhe realizimet e grantit për vitet 2016-2020.



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Në vitin 2016 të ardhurat e realizuara nga granti kapin vlerën 596,125,324 lek. Nga viti 2016 në vitin 2017 kemi një rritje relativisht të lartë me 170,075,055 lek pra për vitin 2017 granti është

766,200,379 lek. Në vitin 2018 granti ka pasur një ulje me 117,847,926 lek pra granti për vitin 2018 ka vlerën 648,352,453 lek. Në vitin 2019 granti është 665,123,136 lek pra ka pasur një rritje prej 16,770,683 lekësh. Ndërsa për vitin 2020 granti ka vlerën 689,130,901 lek dhe ka pasur një rritje prej 24,007,765 lekësh nga viti paraardhës 2019.

Të ardhurat vetanake të Bashkisë Dibrë

Të ardhurat vetanake të bashkisë sigurohen nga mbledhja e taksave, tatimeve, tarifave dhe të ardhurat e tjera.

Taksat janë detyrime financiare që personat fizike ose personat juridike janë të detyruar ti paguajnë bashkisë. Tek taksat përfshihen taksë toke bujqësore, taksë mbi truallin, taksë për kalim të drejtëpërdrejtë të pronësisë, taksë vendore për zënie hapsire, taksë vendore për infrastrukturën, taksë fjetje hoteli, taksë vendore për reklamë dhe tabela, taksë vendore të përkohshme, taksë e mjeteve të përdorura, taksa e pullës dhe taksë autorizim karburanti e lëndë gazi.

Tatimet janë detyrimi shtetëror të cilit duhet ti nënshtrohen persona dhe mallrat sipas përkufizimeve të përcaktuara në ligjet e administrative të shtetit. Tek tatimet përfshihen tatimi I thjeshtuar mbi fitimin, tatim mbi ndërtesat, tatim për shitjen e pasurisë së palujtshme dhe transfertat nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Tarifë quhet një pagesë direkte që në këmbim I jep atij që e paguan një avantazh ose një garanci nga pushteti vendor për personin që e paguan tarifën. Tek tarifet përfshihen: tarifet veterinarë, tarifa për leje transporti, tarifa administrative dhe rregullat, tarife pastrimi, tarife ndricimi, tarife shërbimi, tarifë gjelbëtimi, tarifë për leje veprimtarie, tarifë e përkohshme, kuotë ushqimore, tarife regjistrimi në konvikt, tarifë urbanistike, tarifa nga shitja e mallrave e shërbimeve, tarife tregu ambulant dhe tarifa jotatimore.


Ndërsa tek të ardhurat e tjera përfshihen të ardhurat nga qera trualli, të ardhurat nga qerata për ndërtesa, të ardhurat nga kopshtet e cerdhet, të ardhurat nga qendra për formim profesional, të ardhurat nga parkimi, të ardhurat të tjera sekondare, shitje shtypshkrime, gjobat, të ardhurat të tjera jotatimore, të ardhura nga shërbimi MNZ (Menaxhimi I zjareve), të ardhurat miratim projekt MNZ, të ardhura të tjera nga ndërmarjet dhe pronësia, të ardhurat nga biletat e qendrës kulturor,

të ardhurat nga biletat e muzeut, të ardhura nga qeratat për tokat bujqesore, nga kullotat, hidrocentralet, minierat, renta minerare, nga antenat telefonike, televizive, të ardhurat vendore për shfrytëzimin e lëndës drusore, kamatvonesa, të ardhura të tjera sekondare.

Për vitin 2016 të ardhurat vetanake të Bashkisë u planifikuan 136,605,000 lek, ndërsa realizimi i të ardhurave vetanake të bashkisë ka një vlerën prej 78,125,326 lekësh. Pra të ardhurat e kanë përgjindjen e realizimit 57.19 %.

Në vitin 2017 të ardhurat vetanake të planifikuara kanë vlerën 109,727,000 lek, ndërsa realizimi i tyre arrin në 81,519,831 lek .Domethënë përgjindja e realizimit të të ardhurave vetanake për vitin 2017 është 74.29%.

Grafiku 17: Projeksionet dhe realizimet e të ardhurave vetanake për vitet 2016-2020.



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Për vitin 2018 të ardhurat vetanake te panifikuara arrijne në vlerën 142,341,000 lek , ndërsa realizimi i tyre shkon në vlerën 75,730,027 lek, që do të thotë se përqindja e realizimit për vitin 2018 është 53.20%.


Në vitin 2019 kemi një rritje të ndjeshme të përqindjes së realizimit të të ardhurave në 78.93%, pra kemi 145,187,000 lek që janë planifikuar të ardhurat dhe realizimin që ka një vlerë prej

114,602,573 lekësh. Për vitin 2020 të ardhurat e planifikuara kane një vlerë prej 148,091,000 lekësh, ndërsa realizimi i tyre arrin në vlerën 112,943,440 lek. Pra përqindja e realizimit për vitin 2020 është 76.27%.

Te ardhurat e realizuara nga fondet e deleguara

Fondet të deleguara quhet ajo vlerë monetare që vjen nga Ministritë e linjës dhe jo nga Ministria e Financave dhe që kanë si destinacion institucionet që janë nën varësinë e Bashkisë Dibrë. Këto fonde nuk përdoren apo menaxhohen nga Bashkia Dibrë por vetëm bëhet kalimi në destinacionin e përcaktuar pra në institucionet nën varësi të bashkisë.

Grafiku 18: Projeksionet dhe realizimet e fondeve për vitet 2016-2020.



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Tabela nr.16: Projeksionet dhe realizimet e të ardhurave nga fondet për vitet 2016-2020

Viti	Te ardhurat e planifikuara nga fondet	Te ardhurat e realizuara nga fondet
Viti 2016	1,442,914,607.00	1,370,398,695.00
Viti 2017	1,020,272,006.00	1,484,415,160.00
Viti 2018	902,743,270.00	902,727,409.00
Viti 2019	869,968,902.00	872,613,854.00
Viti 2020	1,307,184,687.00	1,226,360,483.00

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Për vitin 2016 fondet e deleguara të planifikuara kanë vlerën 1,442,914,607 lek, ndërsa realizimi I tyre është bërë në vlerën 1,370,398,695 lek.

Në vitin 2017 të ardhurat e planifikuara nga fondet e deleguara janë 1,020,272,006 lek, ndërsa për sa I përket realizimit kemi vlerën prej 1,484,415,160 lekësh, pra janë realizuar 464,143,154 lek më shumë se sa janë planifikuar.

Në vitin 2018 planifikimi I të ardhurave nga fondet e planifikuara ka vlerën 902,743,270 lek, ndërsa realizimi I tyre arrin në një vlerë prej 902,727,409 lek.

Të ardhura e planifikuara nga fondet e deleguara për vitin 2020 kanë një vlerë prej 1,307,184,687 lekësh, ndërsa planifikimi I tyre arrin në 1,226,360,483 lek.

3.7 Gjendja e llogarisë së Bashkisë Dibër në fundvit për vitet 2016-2020

Gjendja e llogarisë së bashkisë Dibër për vitet 2016-2020 ka pasur një tendencë në rrënjë. Për vitin 2016 gjendja e llogarisë së Bashkisë Dibër është 358,476,969 lek.

Për vitin 2017 gjendja e llogarisë ka pasur një rrënjë prej 150,772,330 lekësh dhe gjendja e llogarisë në fundvit ka një vlerë prej 207,704,639 lekësh.

Tabela nr.17. Gjendja e llogarisë në fundvit për vitet 2016-2020

Gjendja e llogarisë në fundvit		
Viti	Totali(lek)	Totali(euro)
Viti 2016	358,476,969	2,962,620
Viti 2017	207,704,639	1,716,567
Viti 2018	19,117,270	157,994
Viti 2019	27,124,450	224,169
Viti 2020	50,427,649	416,757


Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Nga viti 2017 në vitin 2018 vazhdojmë të kemi një rrënjë edhe më të madhe prej 188,587,369 lekësh dhe gjendja e llogarisë së Bashkisë Dibër në fund të vitit 2018 është 19,117,270 lek.

Kemi një rritje të lehtë të gjendjes së llogarisë nga viti 2018 në vitin 2019 me 8,007,180 lekë dhe gjendja e llogarisë në fund të vitit 2019 është 27,124,450 lek.

Vazhdon rritja edhe për vitin 2020 me një vlerë prej 23,303,199 lekësh më e lartë se në vitin 2019, pra gjendja e llogarisë së Bashkisë Dibër në fund të vitit 2020 është 50,427,649 lek.

Grafiku 19: Gjendja e llogarisë së Bashkisë Dibër për vitet 2016-2020



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

3.8 Detyrimet e prapambetura për Bashkinë Dibër për vitet 2016-2020

Detyrime të prapambetura janë të gjitha ato detyrime që përcaktohen nga një ligj, marrëveshje, kontratë ose vendim I formës së prerë të cilat mbeten të papaguara 30 ditë mbas datës që është specifikuar në kontratë ose me ligj, duke përfshirë këtu edhe periudhën kontaktuale të shlyerjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e qeverisjes qendrore, në njësitë e qeverisjes vendore dhe fondeve special të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Tabela nr.18: Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Dibër për vitet 2016-2020


Detyrimet e prapambetura		
Viti	Totali(lek)	Totali(euro)
Viti 2016	157,645,165	1,302,853
Viti 2017	856,778,635	7,080,815
Viti 2018	466,528,043	3,855,604
Viti 2019	626,937,909	5,181,305
Viti 2020	398,913,331	3,296,804

Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Për vitin 2016 detyrimet e prapambetura kanë vlerën 157,645,165 lek. Në vitin 2017 detyrimet e prapambetura kanë një rritje të madhe dhe arrijnë në vlerën 856,778,635 lek. Në fund të vitit 2018 detyrimet e prapambetura kanë vlerën 466,528,043 lek, pra kanë pësuar një ulje në krahasim me vitin e mëparshëm. Për vitin 2019 do të kemi përsëri një rritje të detyrimeve të

prapambetura në vlerën 626,937,909 lek .ndërsa për vitin 2020 këto detyrime do të pësojnë një ulje dhe do të shkojnë ne vlerën 398,913,331 lek.

Grafiku 20: Detyrimet e prapambetura për vitet 2016-2020



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

3.9 Transfeta specifike dhe transfera e pakushtëzuar për vitet 2016-2020

Grantet janë të ardhura nga qeveria që vijnë pranë pushtetit vendor në formën e transferit të burimeve në mënyrë që pushteti vendor të arrij të plotësoj kushtet që lidhen me aktivitete operative që pushteti vendor ka për të realizuar në të shkuarën apo në të ardhmen. Tek grantet përjashtohen disa forma të ndihmes qeveritare të cilave nuk mund të percaktohet në mënyrë të arsyshme një vlerë dhe ato transaksione me qeverinë të cilat nuk mund të dallohen nga transaksionet normale tregtare të njësisë ekonomike.

Tek transfertat specifike përfshihen grantet me kusht konkurruese për të kryer funksionet dhe kompetencat e deleguara, parashikohen të përdoren për qëllimin e caktuar dhe në fund, nëse nuk përdoren të kthehet në Buxhetin e Shtetit dhe kjo shumë miratohet gjatëviti financiar e në vazhdim. Gjithashtu pjesë përberese të buxhetit janë kredia dhe kostot e njësisë të qeverisjes vendore.

Transfertat e pakushtëzuara janë ato që NJQV-të marrin për përmbushjen e funksioneve të tyre dhe të përbashkëta pa kushtkthimi. Transfertat vertikale të kompensimit, të cilat bazohen në


ndarjen epërgjegjësi dhe funksioneve ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore që synojnë mbështetjen në përgjithësi të shpenzimeve të funksioneve të NJQV-ve dhe shërbimeve publike. Grantet e barazimit ose transfertat e kompensimit horizontal që synojnë mbështetjen që objektivisht u mungojnë të ardhurat dhe burimet kombëtare.

Per vitin 2016 transferta e pakushtezuar ka vleren 140,000,000 lek, ndersa transferta specifike ka vleren 319,520,324 lek qe eshte dyfish me e madhe se sa eshte transferta specifike.

Ne vitin 2017 transferta e pakushtezuar ka vleren 171,463,976 lek, ndersa per sa I perket transfertes specifike arrin ne vleren 401,463,976 lek, qe eshte nje vlere me e madhe se sa dyfishi I trasfertes se pakushtezuar.

Nga viti 2018 verejme se vlerat e transferetes se pakushtezuar jane me te medha se sa vlerat e transfertes specifike, gje qe tregon se kemi nje rritje te nivelit te decentralizimit fiskal ne krahasim me vitet e meparshme. Transferta e pakushtezuar per vitin 2018 ka vleren 389,259,179 lek, ndersa transferta specifike eshte 220,769,927 lek.

Grafiku 21: Transfeta specifike dhe transfera e pakushtëzuar për vitet 2016-2020



Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të marra nga Raportet Financiare të bashkisë së Dibrës

Transferta e pakushtezuar per vitin 2019 e cila eshte percaktuar ne buxhetin e Bashkise Diber ka vleren 414,435,793 lek, ndersa per sa I perket transfertes specifike kemi vleren 239,630,351 lek. Per viti 2020 transferta e pakushtezuar ka vleren 426,671,132 lek, nje vlere qe eshte thujse dyfishi I transfertes specifike e cila ka vleren 257,572,886 lek.

Përfundimet

H1: Decentralizimi fiskal në Republikën e Shqipërisë është në nivelin më të ulët në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor në veçanti në pjesën e të ardhurave fiskale autonome.

Niveli i decentralizimit fiskal në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të merret me rezerve për arsye se organizimi territorial i vendeve të BP është mjaftë asimetrik dhe se kompetencat e autoriteteve lokale janë të ndryshme në vendet e ndryshme dhe për pasojë edhe niveli i financave lokale është në vëllim dhe cilësi mjaftë i ndryshëm.

Vlen të theksohet se nivelin më të ulët të decentralizimit fiskal lokal e ka Shqipëria me 3,1% të PBB-së të argumentuara në kuadër të grafikorit nr.1 të këtij punimi , të ardhurat lokale publike në të ardhurat e konsoliduara publike të Qeverisë Qendrore marrin pjesë me mesatarisht 10.63%.

Gjatë periudhës së analizuar në këtë punim qeveritë lokale në Shqipëri kanë marrë më pak të ardhura si pjesë të PBB-së dhe të ardhurave totale publike se të gjithë vendet tjera në Ballkanin Perëndimor.

H2: Planifikimi dhe realizimi I të ardhurave nga burimet vetiake të bashkisë së Dibrës në periudhën e analizuar (2016-2020) lëvizin nga 4-10% të të ardhurave të përgjithëshme fiskale.

Mbështetur në analizën statistikore të të ardhurave të Bashkisë Dibrë të realizuar në bazë të raporteve financiare konstatojmë se hipoteza e dytë vërtetohet pjesërisht. Për vitin 2016 dhe 2017 realizimi I të ardhurave është respektivisht 3.82% dhe 3.50%.

Këto përqindje janë më të ulëta se sa përqindjet e përcaktuara në hipotezë prandaj nuk mund të themi se hipoteza është e vërtetuar plotësisht. Ndërsa për vitet 2018, 2019 dhe 2020 përgjindjet e realizimit të të ardhurave janë respektivisht 4.66%, 6.94% dhe 5.57%. Për këto vite përqindjet e realizimit të të ardhurave janë brenda përqindjeve të përcaktuara në hipotezë.

H3: Niveli shumë I ulët I të ardhurave fiskale autonome ka ndikuar që likuiditeti I buxhetit të bashkisë së Dibrës të ket trend rramës negative përkundër trendit rritës të detyrimeve të papaguara.

Nga një keqmenaxhim I sistemit të mbledhjes së taksave, tatimeve dhe tarifave kemi njëpërqindje shumë të ulët të realizimit të të ardhurave vetanake në krahasim më të ardhurat e përgjithshme fiskale të Bashkisë Dibrë. Kjo sjell rritjen e detyrimeve të prapambetura. Nga analizat e realizuara konstatojmë se me rritjen e përqindjes së realizimit të të ardhurave ulet detyrimi I prapambetur I bashkisë. Pra nga viti 2018 fillojmë të kemi një rritje të përqindjes së realizimit të të ardhurave dhe po në këtë vit kemi një ulje të detyrimeve të prapambetura. Nga këto analiza të realizuara për vitet 2016-2020 konstatojmë se hipoteza e tretë, vërtetohet

pjesërisht duke qenë se tek detyrimet e prapambetura nuk kemi rritje por një periudhë kohe ka një ulje të detyrimeve të prapambetura.

H4: Covid-19 pandemia nuk ka pasur efekt përmbajtësor negativ në menaxhimin fiskal si në pjesën e të ardhurave dhe në pjesën e shpenzimeve buxhetore.

Pandemia Covid-19 e cila në vendin tonë nisi në vitin 2020 nuk ka pasur një efekt përmbajtësor negative si në pjesën e të ardhurave ashtu edhe në pjesën e shpenzimeve buxhetore. Pandemia në Shqipëri nisi në fillim të vitit 2020 dhe nëse vërejmë analizat e buxhetit të vitit 2019 dhe 2020 vërejmë se kemi një rritje nga njëri vit në tjetrin.

Në vitin 2019 të ardhurat buxhetore kanë vlerën 1,652,339,563 lek , ndërsa në vitin 2020 të ardhurat buxhetore kanë pësuar rritje dhe kanë një vlerë prej 2,028,434,824 lek. Nga viti 2019 në vitin 2020 të ardhurat buxhetore kanë pësuar një rritje prej 376,095,261 lekësh. Për sa i përket realizimit të të ardhurave vetanake të Bashkisë Dibër për vitet 2019 dhe 2020 kemi një zbritje të përqindjes së realizimit të të ardhurave vetanake.

Në vitin 2019 realizimi I të ardhura vetanake është 6.94%, ndërsa në vitin 2020 ka zbritur në 5.57%. Kjo ka ndodhur për faktin se gjatë kohës së pandemisë shumica e bizneseve ishin të mbyllura për një periudhë kohe dhe gjatë kohës që u hapen ishte e vendosur ora policore gjë që ndikoi në ecurin e bizneseve dhe në derdhjen e taksave dhe tatimeve nga ana e tyre.

Rekomandime

1. Reforma administrative-territoriale e cila u miratua me 31 korrik 2014 ka një rëndësi kryesore për pushtetin qendror dhe vendor. Pushteti qendror dhe vendor duhet që në mënyrë efikase të përdorin mundësitë dhe avantazhet që ofron zbatimi I reformës territorial.
2. Decentralizimi nuk duhet të shikohet vetëm si kalim I kompetencave politike dhe administrative nga pushteti qendror në pushtetin vendor por duhet shoqëruar edhe me burimet e mjaftueshme financiare për të plotësuar këto kompetenca.

3. Duhet të kemi një rritje më të madhe të transfertës së pakushtëzuar dhe kjo do të sillte me shume fonde për pushtetin vendor. Në këtë mënyrë organet e pushtetit vendor kanë me shumë mundësi për të plotësuar funksione dhe shërbime për të cilat është e përcaktuar me ligj të kryejnë njësitet vendore dhe pushteti qendror nuk i realizon.
4. Sistemi i mbledhjes së taksave është një tjetër çështje që në Bashkinë e Dibrës ka shumë nevojë për ndërhyrje. Nga mosfunksionimi si duhet i këtij sistemi kemi pasoja të drejtpërdrejta në buxhetin e bashkisë duke sjellë të ardhura vetanake shumë të ulëta. Duhet që të kemi një reformim të këtij sistemi duke vendosur punonjës që janë të trajnuar dhe të aftë për të realizuar këtë punë.
5. Mendoj se duhet të këtë mbledhje dhe trajnime të vazhdueshme me drejtuesit e bizneseve të Bashkisë Dibrë për tu shpjeguar se sa rëndësi ka për bashkinë, për komunitetin dhe për bizneset e tyre që ato të jenë me pagesat e taksave, tatime dhe tarifave, në mënyrë që në qytet të realizohet sa më shumë investime të reja që janë të mirë të gjithë komunitetit.
6. Pushteti vendor dhe pushteti qendror duhet të forcojnë bashkëpunimin institucional që kanë me njëri tjetrin në mënyrë që pushteti vendor të këtë një funksionim sa më cilësor.
7. Pushteti vendor duhet të jetë më afër komunitetit nëpërmjet dëgjësive publike më të shpeshta për të dëgjuar problemet e komunitetit dhe për tu munduar që tu jap zgjidhje atyre. Në këtë mënyrë do të rritet besimi që kanë njerëzit tek pushteti vendor dhe pushteti vendor do të ishte me efektiv dhe efikas.
- 8.** Duhet të këtë një rishyrtim të strategjisë së decentralizimit dhe hatimin e një plani që të këtë një ndikim të drejtpërdrejtë tek buxheti dhe tek rritja e transfertës së pakushtëzuar sepse vetëm në këtë mënyrë pushteti vendor i jepet mundësia për të qenë më afër komuniteti me zgjidhjen e problemeve të tyre.

Literatura

1. Abdelhak Faigy (2012) Measuring Decentralization and the Local Public Sector
2. Agron Haxhimali (2019) “Qeverisja vendore në Shqipëri”
3. Artan Hoxha, “Local self-government and decentralization case of Albania” Tirana, 2002
4. Bahl, R. (2008) “Pillars of Fiscal decentralization”

5. Bilanci I Bashkise Diber per vitin 2016
6. Bilanci I Bashkise Diber per vitin 2017
7. Bilanci I Bashkise Diber per vitin 2018
8. Bilanci I Bashkise Diber per vitin 2019
9. Bilanci I Bashkise Diber per vitin 2020
10. Besley dhe Burgess, 2002 Public Participation.
11. Dabla-Norris E. , (2006). The Challenge of Fiscal Decentralization in Transition Countries.
12. Dobjani, 2007 Ermir Dobjani “ E drejta administrative “ 2007
13. Dragusha, B. & Osmani, E. (2012)“The effects of fiscal decentralization in Albania”
14. Evidenca e shpenzimeve te Bashkise Diber per periudhen janar-dhjetor te vitit 2016
15. Evidenca e shpenzimeve te Bashkise Diber per periudhen janar-dhjetor te vitit 2017
16. Evidenca e shpenzimeve te Bashkise Diber per periudhen janar-dhjetor te vitit 2018
17. Evidenca e shpenzimeve te Bashkise Diber per periudhen janar-dhjetor te vitit 2019
18. Evidenca e shpenzimeve te Bashkise Diber per periudhen janar-dhjetor te vitit 2020
19. Ezcurra R. and P. Pascual. (2008). “Fiscal decentralization and regional disparities: evidence from several European Union countries”
20. Fatos Hodaj, “Local Government in Albania”, Tirane 2001
21. Gjika & Kokona & Mihali 2012 “Planifikimi Strategjik dhe Financiar Afatmesëm dhe Afatgjatë”
22. Gwen Swinburn, (2006), “Local economic development”
23. Ivanyna M. and A. Shah, 2012, “How close is your government to its people? Worldwide indicators on localization and decentralization”
24. Keith Miller, (2002), “Advantages & Diasadvantages of Local Government Decentralization”
25. Martinez-Vazquez, & McNab, (2003), “Fiscal Decentralization and Economic Growth. World Development”
26. Nalas, (2020), “Local government finance indicators in south-east Europe”
27. Nalas,(2018), “Fiscal Decentralization Indicators for South-East Europe”

28. Nina Boschmann 2009, “Fiscal Decentralization and Options for Donor Harmonisation”
29. Raporti financiar per te ardhurat e Bashkise Diber per vitin 2016
30. Raporti financiar per te ardhurat e Bashkise Diber per vitin 2017
31. Raporti financiar per te ardhurat e Bashkise Diber per vitin 2017
32. Raporti financiar per te ardhurat e Bashkise Diber per vitin 2017
33. Raporti financiar per te ardhurat e Bashkise Diber per vitin 2020
34. Realizimi i buxhetit te Bashkise Diber per periudhen janar-dhjetor te vitit 2016
35. Realizimi i buxhetit te Bashkise Diber per periudhen janar-dhjetor te vitit 2017
36. Realizimi i buxhetit te Bashkise Diber per periudhen janar-dhjetor te vitit 2018
37. Realizimi i buxhetit te Bashkise Diber per periudhen janar-dhjetor te vitit 2019
38. Realizimi i buxhetit te Bashkise Diber per periudhen janar-dhjetor te vitit 2020
39. Rodden, J. 2002. The Dilemma of Fiscal Federalism: Grants and Fiscal Performance around the World
40. Rodríguez-Pose A., and N. Gill. 2003. The global trend towards devolution and its implications.
41. Schiavo-Campo, 2007, “Budgeting in Post-Conflict Countries”,
42. Sharma, K. C., (2004), “Decentralization and Citizen Participation”
43. Sistemi Lokal i Taksave
44. Teki Kurti, (2018), “Vetëqeverisja vendore, organizimi dhe funksionimi në Republikën e Shqipërisë dhe të Kosovës” Tiranë
45. Thiessen U., (2003), “Fiscal Decentralisation and Economic Growth in High-Income OECD Countries”
46. UNDP, (2005) Fiscal Decentralisation and Poverty Reduction.